



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Menaxhim Biznesi”

ofruar nga

Universiteti Privat "Albanian University"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Edmond KADIU

PhD. Ani MBRICA

Shtator / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Menaxhim Biznesi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Menaxhim Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 408, datë 26.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 9, datë 07.04.2021, miratuar nga MASR me shkresë Nr. 2600/1 Prot., datë 02.06.2021.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.389, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 79, datë 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 13 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a. 2022-2023 43 Studentë v.a. 2021-2022 42 Studentë v.a. 2020-2021 36 Studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është licencuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010. në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “Albanian University”. Sipas këtij vendimi titulli i lëshuar i diplomës për këtë program studimi është “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në “Menaxher Biznesi”, ofruar me një sistem studimi me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje normale të tij me 3 vite akademike. Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, me Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016 pas riorganizimit të IAL me UMAS Nr. 52, datë 05.02.2016.

Me VBA nr.33, datë 19.05.2017 institucioni ka marrë akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, i cili ka marrë vlerësim pozitiv për një vit , vetëm për studentët e regjistruar nga viti akademik 2010-2011. Me VBA nr. 79 datë 27.10.2018 institucioni ka marrë vlerësim pozitiv për 5 vite për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe 180 ECTS.

Universiteti Privat “Albanian University” përbëhet nga 3 njësi kryesore/Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike i cili përbëhet nga 3 njësi bazë/Departamente:

- Departamenti i Art Dizajn;
- Departamenti i Shkencave Ekonomike;
- Departamenti i Inxhinierive;

Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet si një program studimi i ciklit të parë, me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 6 semestra akademike. Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës. Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon të formojë menaxher për sektorin privat dhe atë publik si dhe specialist marketingu, të cilët nëpërmjet fitimit të njohurive analitike dhe i metodave bashkëkohore nëpërmjet integritit të teorisë në shkencën ekonomike si dhe gërshetimin e saj me shkenca të tjera lejon studentët të përballen me sfidat e tregut të punës. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat, që marrin studentët nëpërmjet harmonizimit të njohurive me bazë teorike, të fushës dhe ato ndihmëse e duke vijuar me thellime në fushat e menaxhimit, marketingut, financës etj., krijojnë bazën për një karrierë kërkimore dhe akademike duke mundësuar vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University” ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trajnuan për standardet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua agjenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë, u zbatua me rigorozitet agjenda e takimeve në 18.12.2023 dhe 19.12.2023, gjatë vizitës në institucion.

GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Përgjegjësin e Departamentit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga **Prof.Asoc. Edmond Kadiu** dhe **PhD. Ani Mbrica** për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjatë të gjithë procesit GVJ u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.79, datë 27.10.2018 janë:

1. Institucioni, të shtojë hapësirat e laboratorëve dhe kapacitetet kompjuterike në shërbim e në përputhje me numrin e studentëve, në godinën kryesore;
2. Institucioni, të nxisë dhe mbështesë stafin akademik për përfshirje më të gjerë në projekte dhe kërkim shkencor ndërkombëtar;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Bazuar në këtë rekomandim. Institucioni sot ka siguruar një laborator informatike të pajisur me mjete brenda standarteve në përmbushje të kërkesave të programit dhe arritjen e objektivave të tij. Konkretisht ky laborator është pajisur me 24 kompjutera dhe 2 laptop që i vijnë në ndihmë Departamentit të Shkencave Ekonomike. Megjithatë duhet theksuar nevoja e pasurimit me mjete kompjuterike desktop pc, në mjedisin e bibliotekës, pasi AU ka vënë në dispozicion një bibliotekë online e-book multifunksional të pasur me ABSCO, ERIC-Education Resources Information Center, Cambridge Journals. Përmirësimi i mjedisit të studimit të studentëve ndihmon në përshtatshmërinë për zhvillimin e aktiviteteve, kërkimore dhe të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit kërkimor, por edhe mësimor. GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur kryesisht. Referenca: R.1 Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore Bulevardi "Zogu I".pdf; 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion
2. Në lidhje me këtë rekomandim Institucioni dhe sidomos Njesia bazë, Departamenti i Shkencave Ekonomike, është angazhuar për të përfshirë stafin akademik në aktivitete të ndryshme të karakterit shkencor si brenda dhe jashtë vendit. Nën kujdesin e Përgjegjës të Departamentit të Shkencave janë nëshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europes Juglindore Tetovë dhe me Higher School of Insurance and Finance (VUZF) ne Sofie. Institucioni, sidomos Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizon çdo vit trajnime të personelit akademik. Nga këto trajnime vlen të përmendim trajnimin e organizuar nga NJSBC, nën kujdesin edhe të Zv.Rektorit për kërkimin shkencor, gjatë vitit akademik 2022-2023, me temë "Konceptet bazë për aplikimet në projekte". Institucioni mundëson kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik si brenda dhe jashtë vendit. Vlen të përmendim këtu se Institucioni mbështet financiarisht botimet kërkimore shkencore në revista me faktor impakti të listuara në Scopus të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. GVJ e konsideron këtë rekomandim të përmbushur plotësisht. Referenca: R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.pdf



Më datë 25.07.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.177/23 Prot., datë 25.07.2024 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 25.07.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr.177/24 Prot., datë 26.07.2024, ka dërguar komente mbi draft raportin.

Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Bachelor Menaxhim Biznesi, AU.

GVJ duke vlerësuar komentet e Institucionit, përcjell qendrimin rreth tyre si me poshte:

1. Standardi I.2 kriteri 3

Në Draft RVJ shprehet se “ GVJ konstatoi se mungon dokumentacioni në lidhje me rregullat dhe procedurën që ndiqet për realizimin e praktikës nga studenti. Gjithashtu mungon dhe raporti që tregon mbi përfitimet që vijnë si rezultat i këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit“.

Qëndrimi i GVJ: GVJ vlerëson punën e bërë nga Institucioni për të përfshirë në rregulloret përkatëse nenet për zhvillimin e praktikës mësimore nga studenti por, duke ju referuar Nenit 37 në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, specifikat e veçanta në lidhje me praktikën e studentit nuk i gjejmë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Pra, GVJ nuk gjeti një rregullore apo udhëzues që tregon se si realizohet procesi i praktikës së studentit në institucionet përkatëse, se si ndiqet ecuria e praktikës së studentit, si vlerësohet ecuria e studentit nga Institucioni ku zhvillohet praktika, dokumentacioni që duhet të paraqesë studenti në përfundim të praktikës dhe si bëhet vlerësimi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar.

2. Standardi III.5 kriteri 2

Në Draft RVJ shprehet se “GVJ sugjeron që për studentët që realizojnë mbrojtjen me temë diplome, institucioni të përgatisë një udhëzues të posaçëm për realizimin e temës së diplomës.”

Qëndrimi i GVJ: GVJ vlerëson argumentin dhe dokumentacionin shtesë që ka dhënë Institucioni në lidhje me udhëzuesin e përgatitjes së temës së diplomës dhe vendos të pranojë komentin për rishikimin e sugjerimit të këtij standardi.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret	Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” i ofruar nga departamenti i Shkencave Ekonomike, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Universitetin Privat “Albanian University”, është në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura tek Strategjia për Zhvillimin Institucional të Albanian University 2023-2028, fq. 4 & 5. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit. Institucioni synon të formojë specialistë në fushën e ekonomisë dhe për kërkimin shkencorë, të raportuara në nivel ndërkombëtar. AU synon gjithashtu të zhvillojë kërkim shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies duke integruar kërkimin me mësimin, si dhe duke përshtatur ofertën universitare me nevojat e tregut të punës. Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e AU të përcaktuara tek strategjia për zhvillimin e AU, tek e cila nënvizohet se AU “ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve për një spektër të gjerë njohurish, të domosdoshme për zhvillimin e karrierës dhe të ardhmes së tyre. Studentët në AU përgatiten për një botë të globalizuar në ndryshim, si kontribues përmes dijeve dhe shërbimit si profesionistë të denjë dhe të shërbejnë në të gjithë botën”. Në kuadër të vizionit të tij AU synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me tregun e punës vendas dhe të huaj. GVJ gjykon se AU nëpërmjet programeve të tij, veçanërisht Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, objekt i vlerësimit, përçon vlerat akademike dhe kulturore të vendit, në përputhje të plotë jo vetëm me karakteristikat e modelit të tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, por çka është më thelbësorja me burimet natyrore e njerëzore për një përdorim efektiv të tyre, me qëllim rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.



	<p><i>Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>AU i udhëhequr nga misioni i formimit të specialistëve në fusha të ndryshme që u përgjigjen me dinjitet sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur, ka hartuar dhe realizon programe, të cilat garantojnë përvetësimin e dijeve dhe njohurive shumëdimensionale. Konkretisht me anë të programit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, AU kërkon të “Të përgatisë specialistë në fushën e ekonomisë dhe për kërkimin shkencor, të raportuara në nivel ndërkombëtar”.</p> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” në ciklin e parë të studimeve, si pjesë e departamentit të Shkencave Ekonomike, hartohet dhe ofrohet në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimin dhe misionin e tij. <i>Megjithatë GVJ gjykon se mungesa e dokumentit mbi strategjinë e këtij programi studimi e zbeh vërtetimin e kësaj përputhje.</i></p> <p><i>Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë objektivat e programit, si një program që synon të formojë studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e ekonomisë. Gjithashtu, fitimi i njohurive analitike dhe i metodave bashkëkohore nëpërmjet integritit të teorisë në shkencën ekonomike si dhe gërshtimin e saj me shkencë të tjera lejon studentët të përballen me sfidat e tregut të punës.</p> <p>GVJ gjykon që ky program përputhet me Strategjinë e Zhvillimit Institucional, e cila i kushton vëmendje të veçantë gjetjes së mënyrave novatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit dhe përtej tyre duke kontribuar në realizimin e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.</p>

	<p>Statuti i Institucionit, Rregullorja e Përgjithshme, Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit të studimit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike, në të cilat saktësohet se departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimit themelore akademike të institucionit. Programet janë të organizuara dhe mundësojnë ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha cikleve të studimit.</p> <p><i>Referenca: 1.2 Statuti AU;</i></p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e përgjithshme; 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>											
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, një nga 3 departamentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, me Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016 pas riorganizimit të IAL me UMAS Nr. 52, datë 05.02.2016. Ky program studimi është licencuar me VKM nr. 408, datë 26.05.2010. Njësia bazë ka përvojë të mjaftueshme dhe cilësore për të ofruar këtë program, përvojë që rrjedh sa nga e kaluara dhe tradita e institucionit, aq edhe nga niveli profesional dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe bashkëpunimet me institucione të tjera të njohura si brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Referuar (Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi tab 1) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, për vitin akademik 2022-2023 ka angazhuar gjithsej 86 staf akademik nga të cilët 39 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 47 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikim:</p> <table border="1" data-bbox="614 1635 1331 1872"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>3</td> <td>8</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike		PAE	PAK	Prof.Dr	1	6	Prof.Asoc	3	8
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike											
	PAE	PAK										
Prof.Dr	1	6										
Prof.Asoc	3	8										



Dr/PhD	16	19
Msc	19	14
Gjithsej	39	47

Ndërsa Departamenti i Shkencave Ekonomike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka angazhuar gjithsej 32 staf akademik nga të cilët 14 janë staf akademik efektiv dhe 18 janë staf akademik me kontratë me kualifikim:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Ekonomike	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	3
Prof.Asoc	2	5
Dr/PhD	5	6
Msc	6	4
Gjithsej	14	18

Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përbëhet nga 21 pedagogë, nga të cilët 62% janë me kohë të plotë (13 pedagogë) dhe 38 % me kohë të pjesshme (8 pedagogë).

GVJ gjykon që njësi bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie bazuar tek trajnimet profesionale të stafit, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit që IAL ndjek për marrjen e stafit të ri, raportimin e punës kërkimore shkencore si dhe analizën vjetore të departamentit mbi arritjen e objektivave të programeve të studimit.

Referenca: 5. Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi

Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion

Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë,

GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore. Struktura e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi është e organizuar sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në VKM nr. 41 datë 24.01.2018 dhe ndryshimeve të përcaktuara për të (VKM nr.185 datë 25.03.2021). Njësi

<p>përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në proces akreditimi është Departamenti i Shkencave Ekonomike, ndërsa njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>GVJ gjykon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse për programin e studimit. AU synon që me kërkimin shkencor të ketë një impakt teorik dhe praktik mbi shoqërinë, ekonominë, shkencat mjekësore dhe më tej duke transferuar njohuritë e zhvilluara përtej komunitetit akademik të brendshëm. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi synon të formojë menaxherë për sektorin privat dhe atë publik si dhe specialistë marketingu. Në dokumentin Strategjia për Zhvillimin Institucional të “Albanian University”, në çështjen V, fq.25-27 specifikohen drejtimet strategjike kryesore mbi të cilat IAL do të mbështesë aktivitetin e tij në përmbushje të misionit dhe vizionit për programet e ofruara të studimit sipas strategjisë së planifikuar për periudhën 2023-2028.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi se njësia kryesore analizon në mënyrë të vazhdueshme punën kërkimore shkencore dhe rezultatet e saj. <i>GVJ do të sugjeronte përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit.</i></p> <p>Në lidhje me kodifikimin e programit të studimit, IAL është duke përgatitur propozimin për variantet e kodeve të programeve të studimit në përputhje me përcaktimet nga VKM-së nr.310 datë 11.05.2022.</p> <p><i>Referenca: Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e përgjithshme; 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: R2GRRE~1.PDF.PDF</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të AU u konstatua se programi Bachelor në</i></p>

	<p><i>“Menaxhim Biznesi” përbën risi në ofertën akademike të fakultetit, të transformuar për t’ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.</i></p> <p><i>GVJ gjykon që njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësi të lartë në mësimdhënie bazuar tek trajnimet profesionale të stafit, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit që IAL ndjek për marrjen e stafit të ri, raportimin e punës kërkimore shkencore si dhe analizën vjetore të departamentit mbi arritjen e objektivave të programeve të studimit. Megjithatë IAL duhet të respektojë aktet rregullatore në fuqi në lidhje me raportin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ku 70% duhet të mbulohet nga personeli me kohë të plotë. (Pika 2b-ii e Vendimit Nr. 418 datë 10.05.2017).</i></p> <p><i>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Departamenti i Shkencave Ekonomike, si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe ka angazhuar staf të kualifikuar. Pothuajse të gjitha lëndët e programit të studimit mbulohen nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm i Departamentit (90 %), ndërsa personeli nga departamentet e tjera të AU mbulon vetëm 10% të lëndëve të programit. Programi i studimit Bachelor në



<p>përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>“Menaxhim Biznesi” lejon bashkërendim të stafit në disa disiplina formimi, si ekonomiksi, financa dhe kontabiliteti, informatika, statistika, etj. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të AU duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës mësimore dhe kërkimore të njësi në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e AU.</p> <p><i>Referenca: 1.2 Statuti AU;</i></p> <p><i>Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e përgjithshme; 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 5. Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikqytjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi. Institucioni, ka ndërmjetësuar 31 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (biznese, institucione publike, OJF) të cilët japin një kontribut tepër të vyer për lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës, nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore si dhe institucione të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në dokumentin Strategjia për Zhvillimin Institucional të “Albanian University”, tek çështja 6. IAL specifikon se AU synon të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të OECD dhe BE-së rrjetet aktuale duke inkurajuar bashkëpunimin për aktivitete akademike, kërkimore shkencore dhe për programe të shkëmbimit të eksperiencave profesionale. Gjithashtu AU synon forcimin e partneriteteve strategjike duke u angazhuar në marrëveshje bashkëpunimi me ente publike e private, me partnerë vendas apo të huaj për veprimtari të përbashkëta akademike dhe kërkimore, për praktika mësimore dhe konsulencë ndaj të tretëve. Personeli akademik mund të përfshihet në bashkëpunime nëpërmjet shkëmbimit të përvojave akademike, pjesëmarrjes në kërkime dhe projekte të</p>

	<p>përbashkëta si dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore të përbashkëta.</p> <p><i>Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të arritura nga institucioni Njësia përgjegjëse për programin mundëson realizimin e praktikave të studentëve. Praktika mësimore zhvillohen në institucionet e miratuara nga Dekani dhe nën mbikqyrjen e një pedagogu të caktuar nga Departamenti.</p> <p><i>GVJ konstatoi se mungon dokumentacioni në lidhje me rregullat dhe procedurën që ndiqet për realizimin e praktikës nga studenti. Gjithashtu mungon dhe raporti që tregon mbi përfitimet që vijnë si rezultat i këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p> <p>Në rregulloret e Institucionit dhe të programit të studimit citohet se praktika i nënshtrohet të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, njësoj si për detyrime të tjera, por mungon një dokumentacion që e vërteton këtë fakt. Praktika mësimore realizohet në semestrin e 6-të të studimeve të programit, e cila mundësohet në sajë të marrëdhënieve të bashkëpunimit që ka vendosur institucioni. Takimi me studentët nxorri në pah vlefshmërinë e praktikave mësimore, të cilat ju shërbejnë atyre për të fituar shprehitë e para të punës praktike si edhe njohjen me tregun e punës. GVJ vlerëson se në drejtim të praktikave mësimore, rrjeti i bashkëpunimeve të njësive përgjegjëse për programin, përbën një avantazh.</p> <p><i>Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e pergjithshme; 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>




<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Krahas marrëveshjeve të bashkëpunimit, AU organizon panairin e punës me pjesëmarrjen e bizneseve nga sektorë të ndryshëm ku shërben si një urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe tregut të punës.</p> <p><i>GVJ gjykon se njësia përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Shkencave Ekonomike duhet të hartoj raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”.</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Panairi i Punës 2023! – ALBANIAN UNIVERSITY</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Departamenti i Shkencave Ekonomike, si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marëdhënie bashkëpunimi. Në drejtim të praktikave mësimore, GVJ vlerëson se rrjeti i bashkëpunimeve të njësisë përgjegjëse për programin, përbën një avantazh. Por IAL duhet të institucionalizojë praktikë mësimore duke krijuar dokumentacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e këtij procesi. Gjithashtu njësia përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Shkencave Ekonomike duhet të hartojë raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është licencuar me VKM nr. 408, date 26.05.2010. në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar "Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private "Albanian University". Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, me Vendim Senati Nr. 51/2 prot., datë 09.03.2016 pas riorganizimit të IAL me UMAS Nr. 52, datë 05.02.2016.</p> <p>Me VBA nr.33, datë 19.05.2017 institucioni ka marrë akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, i cili ka marrë vlerësim pozitiv për një vit , vetëm për studentët e regjistruar nga viti akademik 2010-2011. Me VBA nr. 79 datë 27.10.2018 institucioni ka marrë vlerësim pozitiv për 5 vite për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe 180 ECTS. Programi është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), konkretisht si një sistem studimi me kohë të plotë, me 180 ECTS, me kohëzgjatje 3 vite akademike. Sipas planit mësimor ky program përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë Bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (5 lëndë/module/32 ECTS/ 18%); - Lëndë Karakterizuese- përgatitje për disiplinën shkencore (15 lëndë/module /97 ECTS/ 54%); - Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese- ndërdisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje (5 lëndë/module /25 ECTS/ 14%); - Lëndë Plotësuese- gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale (4 lëndë/module/20 ECTS/ 11%); - Detyrimet Përnbyllëse- Provim Diplome/6 ECTS/ 3%); <p>Plani mësimor është i organizuar në 6 semestra të shpërndarë në tre vite akademike, me lëndë e module të vlerësuara me</p>

	<p>kredite. Në plan pasqyrohen 29 lëndë me 31 module. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e një provimi të përgjithshëm formimi ose të përgatitjes dhe mbrojtjes të një punimi diplome, në varësi të notës mesatare. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i> <i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i> <i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionit, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi synon të formojë menaxherë për sektorin privat dhe atë publik si dhe specialistë marketingu, të cilët nëpërmjet fitimit të njohurive analitike dhe i metodave bashkëkohore nëpërmjet integritit të teorisë në shkencën ekonomike si dhe gërshetimin e saj me shkencat e tjera lejon studentët të përballen me sfidat e tregut të punës.</p> <p>Përcaktimi i rezultateve të të nxënimit në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta. Rezultatet e të nxënimit të pasqyruara tek syllabuset përkatëse të lëndëve të ofruara nga programi i studimit janë të shprehura në terma të njohurive, aftësive dhe kompetencave që përfiton studenti.</p>

	<p><i>Nga ana tjetër nevojitet që këto rezultate të të nxënit të programit të studimit të jenë pjesë e një dokumenti që përcakton strategjinë e zhvillimit të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Në përpjekje për tu përshtatur dhe përditësuar me kërkesat dhe trendet e tregut të punës si dhe të fushës së studimit, departamenti si njësi bazë e programit të studimit duhet të përditësojë literaturën e lëndëve të këtij programi studimi si dhe t'i përfshijë në përditësimin periodik të listës së librave në bibliotekë.</i></p> <p><i>GVJ gjykon që programi duhet të garantojë profilizimin apo specializimin e studentit në një fushë të caktuar të menaxhimit të biznesit dhe të mos zhvendoset në drejtim të fushës së financës, siç vihet re dhe nga pesha që zënë lëndët me karakter financiar në kurrikulën e këtij programi studimi.</i></p> <p>Nga këndvështrimi i studentëve të regjistruar në këtë program studimi, lëndët e përfshira në këtë program, përmbajtja e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Menaxhimit, e cila përforcohet nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe nga organizatat publike dhe operatorët e biznesit.</p> <p>GVJ gjykon që njësia kryesore është e pajisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.6 Procedure e pasurimit të bibliotekës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.8 Leksione të hapura.pdf.pdf; Leksione të hapura 2018-2023 Dep. Shkencave Ekonomike.pdf</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek Plani mësimor edhe Rregullorja e programit të studimit, lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmendja që i</p>

<p>veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi. Ashtu sikurse është pasqyruar edhe në Kriterin 1 të këtij Standardi, GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore. GVJ gjykon që programi i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i> <i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është i organizuar në module të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, të ngjashëm dhe/ose integruës si edhe module formuese me zgjedhje, përveç praktikës mësimore profesionale dhe përgatitjes së diplomës, të cilat e kanë të përcaktuar qartë përmbajtjen e tyre, mënyrën e organizimit si edhe format e mësimdhënies. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi përcakton ngarkesën në kredite lidhur me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, specifikisht tek kategoria D (20 ECTS ose 11%) - lëndë plotësuese ku përfshihet Praktikë dhe tek kategoria E (6 ECTS ose 3%) detyrime përmbyllëse, në përputhje me specifikimet ligjore.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i> <i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” është një institucion jo-publik i Arsimit të Lartë dhe nuk gëzon status të veçantë në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi. GVJ konstaton se forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Në kreun III të rregullores së programit të studimit përcaktohen kriteret e</p>

<p>përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>pranimit të studentëve, dokumentacioni, regjistrimi dhe kohëzgjatja e studimit dhe transferimet. Kurse financimi bazohet tek të ardhurat e tarifave të studimit dhe aktivitetet tregtare.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 18, fq.28</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Menaxhim Biznesi” është i njëjtë me programe studimi në të njëjtën fushë dhe me të njëjtën emërtesë, të ofruar nga Universiteti Barleti, Kolegji Universitar “Logos”, Kolegji Universitar “Qiriazi”, etj. Kjo lehtëson mobilitetin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në VKM nr.310 datë 11.05.2022 “Për përmbajtjen e kodifikimit të programeve studimore në IAL” dhe UMAS nr.31 datë 15.11.2022 “Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, për programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Menaxhim Biznesi” AU është duke përgatitur propozimin për variantet e kodeve të programeve të studimit.</p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja ku janë parashikuar edhe programe të përbashkëta, por për momentin nuk ofron programe të ciklit të parë të studimit, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, si diploma të përbashkëta midis institucioneve të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon që njësia kryesore është e pajisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë</i></p>

	<p><i>programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e menaxhimit të biznesit. Megjithatë programi duhet të garantojë profilizimin apo specializimin e studentit në një fushë të caktuar të menaxhimit të biznesit dhe të mos zhvendoset në drejtim të fushës së financës. Gjithashtu njësi bazë duhet të kujdeset që rezultatet e të nxëniet të programit të studimit të jenë pjesë e një dokumenti që përcakton strategjinë e zhvillimit të këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Në përpjekje për tu përshtatur dhe përditësuar me kërkesat dhe trendet e tregut të punës si dhe të fushës së studimit, departamenti si njësi bazë e programit të studimit duhet të përditësojë literaturën e lëndëve të këtij programi studimi si dhe t'i përfshijë në përditësimin periodik të listës së librave në bibliotekë.</i></p> <p><i>GVJ gjykon që programi i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University”, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.55, datë 26.05.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 4 vite, me afat vlefshmërie deri në 25/05/2027.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Art Dizajn; 2. Departamenti i Inxhinierive; 3. Departamenti i Shkencave Ekonomike;



Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike pwr vitin akademik 2022-2023 ka në përbërjen e tij, 39 personel akademik efektiv(PAE) i ndarë në tre njësi bazë, si:

Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada
Departamenti i Shkencave Ekonomike	14	1 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. 5 – Dr. 1 – Dr. në Proc. 5- Msc
Departamenti i Inxhinierive	18	0 – Prof. Dr. 1 – Prof. Asoc. 7 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 10 - Msc
Departamenti i Art Dizajnit	7	0 – Prof. Dr. 0 – Prof. Asoc. 4 – Dr. 0 – Dr. në Proc. 3 - Msc
Total	39	39

Secila njësi bazë, pëfshirë edhe Departamentin e Shkencave Ekonomike, përmbush kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësjve bazë.

Departamenti i Shkencave Ekonomike, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	1	1	2	1	3
Prof. Asoc.	3	6	2	6	2	5
Dr./PhD.	6	4	5	7	5	6
Msc.	5	6	5	6	6	4

Totali	14	17	13	21	14	18
<p>Nga sa më sipër 34% e personelit të këtij departamenti mban titujt Prof. Dr dhe Prof. Asoc. Dr., 11 pedagogë, përkatësisht 3 të brendshëm dhe 8 me kohë të pjeshme; 34% mbajnë gradën shkencore Doktor, përkatësisht 5 të brendshëm dhe 6 me kohë të pjeshme; 4 % është në proces për marrjen e gradës shkencore Doktor, 1 pedagog i brendshëm; dhe 28 % e personelit të këtij departamenti mbajnë titullin MSc. konkretisht 5 pedagogë të brendshëm dhe 4 pedagogë me kohë të pjeshme.</p> <p>Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia. ▪ Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. ▪ Pjesëmarrjes në projekte ▪ Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus. <p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore. Megjithatë GVJ gjykon se njësia bazë e këtij programi studimi duhet të dokumentojë listën e mobilitetit si për pedagogët edhe për studentët incoming dhe outgoing.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf, Tabela 4, fq.7</i></p> <p><i>Referenca: 1.1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p> <p><i>Referenca: 3.1.d Axhenda e trajnimeve e stafit akademik 2022-2023.pdf; R.2.e Leksion i hapur "Mobility of Teaching" në kuadër të Erasmus+ KA131, Prof. Massimiliano</i></p>						

	<p><i>Giacolone.pdf; R.2.f Trajnim me temë "Konceptet bazë për aplikime në projekte".pdf.</i></p> <p><i>Reference: 3.11 Botim i stafit akademik në revistën optime.pdf; R.2.h Procedurë për mbështetje financiare për kërkimin shkencor për botime në Scopus.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në përputhje me specifikat e planit të studimit, departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në procesin e zhvillimit të praktikave mësimore harton programin e praktikës profesionale si dhe cakton personelin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në institucionin apo biznesin e caktuar. Për këtë program studimi ky kriter nuk aplikohet pasi për praktikën mësimore angazhohet personel akademik, ndërsa programi i studimit nuk përfshin praktika laboratorike e klinike.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njesisë bazë, veçanërisht i Rregullores së departamentit të Shkencave Ekonomike (neni 11), konfirmojnë se koordinatori i departamentit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikës profesionale në përputhje me objektivat e tij. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AU koordinatori i departamentit emërohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Drejtuesit të Departamentit.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB; 2.4 Koordinatorët e programit të studimit.pdf.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Ekonomike, përgjegjës për programin Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprorë institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.</p> <p>Mbi bazën e legjislacionit udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel fakulteti dhe më tej, departamenti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.</p> <p>Rregullorja e brendshme e departamentit dhe Rregullorja e Fakultetit, të cilat miratohen me Vendim të Senatit Akademik, përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet e departamentit me studentët. GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni.</p> <p><i>Referenca: 1.2 Statuti AU.</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e përgjithshme; 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike</i></p>

	<p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të AU 2023-2028, si dhe në Planet mësimore vjetore. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Menaxhim Biznesi. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit (Kreu IV & V) dhe Rregulloren e programit (Kreu III & IV) janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar është deri në masën 40% të totalit të pikëve dhe konsiston në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktivizimi dhe pjesëmarrja në seminare; ▪ Provim i ndërmjetëm; ▪ Detyrë kursi, punë grupi, prezantime ose ese <p>Frekuentimi leksioneve dhe seminareve në këtë program studimi është i detyrueshëm deri në masën 75% të seancave (Neni 15- Rregullore e programit të studimit).</p> <p><i>Referenca: Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p>

	<p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat iu përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: Rregullorja e Programit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve, Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe Statuti i AU. Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, transferimi i studimeve, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit janë në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, me udhëzimet e përvitshme të MASR, të cilat miratohen me vendim Senati Akademik. Këto kritere parashikohen në Rregulloren e programit të studimit sipas nenit 10. Çështjet e mësipërme i gjejmë të specifikuar në Rregulloren e Departamentit (Kreu III) , Rregulloren e programit të studimit (Kreu III) si dhe në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve (Kreu II & III)</p> <p>Procesi i pranimit të studenteve bëhet mbi bazë të një transparence të plotë, ku kriteret e pranimit, afatet, lista e kandidatëve fitues etj. shpallen në faqen zyrtare të IAL-së dhe mjetet e tjera në dispozicion të informimit.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB; 5.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 5.1 Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit.pdf.; 5.2 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo</p>	<p>Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t’u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënies, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve</p>

<p>orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>dhe literaturën. Formatit i syllabuseve përputhet me standardet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e pare të mësimit. GVJ konstaton se programet lëndore përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 4.</p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut, departamenti si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përpjekjet për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të programit të studimit i bën pjesë të planit vjetor të punës së departamentit. Lektorët e lëndëve të këtij program studimi, në bashkëpunim me koordinatoret e gjuhë-lëndëve përkatëse rishikojnë çdo fillim viti akademik syllabuset e lëndëve/moduleve për përditësimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës duke përfshirë literaturën bashkëkohore. Ky proces mbikëqyret edhe nga Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti, të cilët pasi rishikojnë ndryshimet e realizuara në syllabus informojnë në formë shkresore NJSBC. Më pas ndryshimet dhe përditësimet ia propozojnë Përgjegjësit të departamentit, i cili në formë shkresore informon Zyrën e Zhvillimit për Kurrikulat dhe Mësimin si dhe për dijeni Dekanin e Fakultetit dhe Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin për ndryshimet e propozuara në syllabus nga lektorët.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në rregulloren përkatëse dhe manualin e cilësisë si dhe sipas vizitës në institucion, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka detyra thelbësore për të mbështetur procesin e përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Megjithatë, nga shqyrtimi i syllabuseve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se ka nevojë për përditësimin e tyre me literaturë bashkëkohore.</i></p>



	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e AU paraqiten qartë politikat e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf; (Neni 10 & 12)</i></p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf; 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni. Gjithashtu, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të AU 2023-2028, si dhe në Planet mësimore vjetore. GVJ konstaton se programet lëndore të këtij programi studimi përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme. Megjithatë kërkohet një përditësim i syllabuseve/moduleve të këtij programi studimi me literaturë bashkëkohore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	Programi që po vlerësohet, Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe

<p>aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues. Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Zhvillimi i praktikës mësimore gjatë një semestri ka ndikuar në rritjen e efektivitetit të tyre.</p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf, Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i></p> <p><i>1.1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Reference; 1.10 Konferenca studentore.pdf.; 5.13 Aktivitete ekstrakurrikulare.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.8 Leksione të hapura.pdf.; 5.6 Leksion i hapur "Si të punësohesh".pdf.; 5.7 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Siç konstatohet nga Plani mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të përshkallëzuara. Kështu, në vitin e parë dhe të dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të përgjithshme, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale. Planet mësimore si edhe dokumentat plotësuese sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p>

	<p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf; Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf, Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit dhe të programit të studimit konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si menaxherë për sektorin privat dhe atë publik si dhe specialistë marketingu. Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si dhe deri diku profilin përkatës. Plani mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kriterëve të standardit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit filojnë të realizohen në vitin e dytë të studimit dhe kryesisht në vitin e tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e Përgjithshëm Përfundimtar.</p> <p>Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është deri në përputhje me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruar, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përfutur.</p> <p><i>GVJ gjykon që programi duhet të garantojë profilizimin e studentit në një fushë të caktuar të menaxhimit të biznesit, në marketing duke qënë se shprehet edhe në rregulloren e programit se synon të formojë specialistë marketingu. Aktualisht ky program ka më shumë drejtim financiar, siç vihet re dhe nga pesha që zënë lëndët me karakter financiar në kurrikulën e këtij programi studimi dhe sidomos tek lëndët e profilit (2 nga 4 lëndët e profilit janë lëndë financë), apo të drejtimit juridik tek lëndët e profilit (2 nga 4 lëndët e profilit janë të drejtimit juridik).</i></p> <p><i>Gjithashtu GVJ gjykon se Njësia bazë e programit të studimit duhet të konsiderojë shpërndarjen e lëndëve ku në kategorinë bazë të ketë vetëm lëndë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të formimit profesional apo financiar si Bazat e Financës, Hyrje në mendimin ekonomik dhe Matematikë financiare. Në kategorinë karakterizuese duhet të ketë më tepër lëndë të fushës së menaxhim biznesit.</i></p>

	<p>GVJ konkludon se deri diku struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Rregullorja e Programit dhe Rregullorja e Departamentit, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor. Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Menaxhim Biznesi. Strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf.; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf;</i> <i>Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencia e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme. Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik duke përfshirë literaturën, metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies, etj. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p>

	<p>Megjithatë, siç përmendet edhe në Standardin II.3, Kriteri 5, përditësimi i syllabuseve duhet të marrë parasysh përfshirjen e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejtat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë.</p> <p><i>Referenca: Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.pdf.;</i></p> <p><i>Referenca: 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf; 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive ndaj drejtimit të biznesit, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit të prodhimit dhe operacioneve, menaxhimit financiar etj. Megjithatë GVJ gjykon që programi duhet të përfshijë më tepër shumëllojshmëri njohurish që lidhen me fushën e menaxhimit të biznesit dhe jo duke u fokusuar dhe profilizuar në drejtimin financiar.</p> <p>Njësia bazë konsideron nevojë parësore analizën e vazhdueshme të tregut, të cilën e ka realizuar dhe e ka përdorur për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies si edhe rritur efektivitetin e studimeve akademike, por nevojitet që analiza të nxjerr në pah nevojat aktuale të tregut të punës, aftësitë që kërkohen më tepër për të cilët nevojitet përgatitja e studentëve që do të dalin së shpejti në tregun e punës.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf.; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf; Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p>



	<p><i>Referenca: 1.7 Studimi i tregut të punës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Objektivat formuese të programit; ▪ Harmonizimi deri diku i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese; ▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike; ▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës; ▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies; ▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit ▪ Zhvillimi praktikës pranë institucioneve private dhe publike ▪ Informacioni që gjenerohet nga Alumni eksperiencën e të cilëve shërben si burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. <p>si dhe rolin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces formues që shërben si një urë lidhëse për studentin për të integruar teorinë e në auditor me praktikën konkrete që shfaq tregu i punës, njësia bazë i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus.</p> <p>GVJ mbështet përfundimin se programi i studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve si dhe punësimin e studentëve në përshtatje deri diku me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Gjithsesi GVJ mbetet në gjykimin se IAL duhet të sigurohet që programi i studimit garanton llojshmëri specialitetesh në fushën e menaxhimit të biznesit duke kapërcyer fokusin vetëm në drejtim financiar.</i></p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf.; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB; 5.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020.pdf.pdf</i></p>



	<p>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf; Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</p> <p>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021- 2022.pdf.pdf</p> <p>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</p> <p>Referenca: 1.7 Studimi i tregut të punës.pdf.pdf</p> <p>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</p> <p>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</p> <p>Referenca: 2.7 Model Pyetësor ALUMNI.pdf.pdf</p>			
Konkluzione	<p>Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si dhe deri diku profilin përkatës. GVJ gjykon që programi duhet të garantojë profilizimin e studentit në një fushë të caktuar të menaxhimit të biznesit, në marketing duke qënë se shprehet edhe në rregulloren e programit se synon të formojë specialistë marketingu. Gjithashtu GVJ gjykon se Njësia bazë e programit të studimit duhet të konsiderojë shpërndarjen e lëndëve sipas kategorive perkatese. Nga ana tjetër mund të konkludojmë se struktura e programit të studimit i përfaqësohet deri diku programeve të ngjashme ndërkombëtare. Gjithashtu, strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi menaxhimin e organizatave të ndryshme publike dhe private, por nevojitet që programi i studimit të përfshijë më tepër shumëllojshmëri njohurish që lidhen me fushën e menaxhimit të biznesit dhe jo të fokusohet në drejtimin financiar. Gjithashtu nevojitet përfshirja e literaturës bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi për t'i ofruar studentëve të rejtat më të fundit në fushën në të cilën studiojnë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Ekonomike, si njësi bazë e programit të studimit implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Lidhur me aktorët e brendshëm departamenti në bashkëpunim me Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë realizon me studentët pyetësorë dhe focus-grupe dy herë në vit. Studentët në fund të çdo semestri shprehin mendimin e tyre mbi cilësinë e procesit mësimor, format e ndryshme të mësimdhënies, vlerësimin dhe kontrollin e dijeve. Këndvështrimet e aktorëve të tjerë si institucionet partnere, konkurenca dhe ecuria e dinamikës së tregut janë pjesë e analizës së tregut që bën institucioni.</p> <p><i>Por nevojitet që IAL të përfshijë analizën e përfitimeve që vijnë si rezultat i bashkëpunimit me aktorët e jashtëm e cila dhe formulimit të strategjisë për zhvillimin e programit të studimit.</i></p> <p>Gjithashtu AU nëpërmjet një pyetësori të caktuar merr mendimet, opinionet të bordit të tregut të punës, Alumni të cilët nëpërmjet eksperiencave të tyre në tregun e punës pas diplomimit në këtë IAL ndihmojnë në identifikimin e ndërhyrjes për përmirësim në këtë program studimi. Për më tepër integrimi i eksperiencave Erasmus të stafit dhe studentëve është një instrumentë tjetër që i shërben procesit të përmirësimit dhe përshtatjes së programit të studimit.</p> <p><i>Gjithsesi, nevojitet që IAL të dokumentojë mobilitetin e stafit dhe të studentëve.</i></p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.f Pyetesoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetesorit drejtuar personelit akademik per mesimin online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf; 6.7.e Shkrese fokus-grupe 2022-2023.pdf.; 2.7 Model Pyetesor ALUMNI.pdf.pdf</i></p>

	<p><i>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 1.7 Studimi i tregut të punës.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në statutin e IAL (Neni 47 & 49) gjejmë të pasqyruar përfshirjen e studentëve dhe integrimi i mendimit të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese dhe në proceset e vendimmarrjes të AU. Siç përmendet edhe në kriterin e mësipërm pyetësorët me studentët (dy herë në vit), dhe focus-grupet përfaqësojnë përfshirjen e tyre. Gjithashtu dhe pyetësi me Alumnin që përfshin mendimet/opinionet e bordit të tregut të punës, Alumnin.</p> <p><i>Referenca: 1.2 Statuti AU;</i></p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor në AU.pdf.; 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.f Pyetesoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf; 6.7.e Shkresë fokus-grupe 2022-2023.pdf.; 2.7 Model Pyetësor ALUMNI.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe</p>	<p>Bashkëpunimi dhe marrëdhënia e qëndrueshme me institucionet partnere nga tregu i punës me të cilat IAL ka marrëveshje krijojnë mundësinë që Departamenti si njësia bazë përgjegjëse për përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen e programit të studimit të marrë feedbackun e duhur për të ndërmarrë strategjitë dhe hapat e duhur drejt procesit të përditësimit me ndryshimet e kërkuara. <i>Por nevojitet që këto mendime apo propozime të jenë pjesë e një raporti që tregon mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i></p>

institucione publike e private.	<p><i>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Referenca: Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 1.7 Studimi i tregut të punës.pdf.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>IAL implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, sic janë studentët, Alumni dhe bashkëpunorë të ndryshëm. Megjithatë GVJ gjykon se IAL duhet të dokumentojë përfitimet që vijnë si rezultat i bashkëpunimit me aktorët e tregut të punës ku ndërmjet të tjerave evidentohet edhe mendimet apo sugjerimet që vijnë në lidhje me përmirësimin e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksionet (855 orë totale në auditor) • Seminarat (833 orë totale në auditor) • Detyra Kursi.Punë grupi/Prezantime/Ese

<p>kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Praktika profesionale • Leksionet e hapura <p>Ndërsa tre të parat janë pjesë e vlerësimit të lëndës, dy të fundit shërbejnë për konsolidimin e njohurive teorike dhe nëpërmjet tyre, krijimin e shprehive praktike.</p> <p>Këto metoda kryesore të mësimit janë përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve. Përmirësimi i metodave të mësimit përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe reflektohet jo vetëm në dokumentat zyrtarë si: Rregullore e Departamentit, Vendim për sigurimin e cilësisë në nivel departamenti, Procedurë e rishikimit të syllabuseve dhe Analiza vjetore e departamentit, por edhe në takimet e GVJ me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimit. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimit, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimit të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për t'iu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg. Dep. Shkencave Ekonomike.pdf.pdf;</i></p> <p><i>ReferencaL 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.pdf;</i></p> <p><i>ReferencaL 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>ReferencaL 1.1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.8 Leksione të hapura.pdf.; 5.6 Leksion i hapur "Si të punësohesh".pdf.; 5.7 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimit dhe mësuesit dhe kontrollit të dijeve parashikohen në</p>

<p>përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve. Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” përfshin format e mësimiit teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit, punë grupi apo ese. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës. Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik.</p> <p><i>Referenca: 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf.; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>ReferencaL 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Institucioni mundëson kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik si brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik angazhohet në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit, ku nëpërmjet vizitave dhe shkëmbimeve në institucionet e huaja universitare, u mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.</p> <p><i>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3.1.d Axbenda e trajnimeve e stafit akademik 2022-2023.pdf.; R.2.e Leksion i hapur "Mobility of Teaching" në kuadër të Erasmus+ KA131, Prof. Massimiliano</i></p>



	<p><i>Giacolone.pdf; R.2.f Trajnim me temë "Konceptet bazë për aplikime në projekte".pdf.</i></p> <p><i>Reference: 3.11 Botim i stafit akademik në revistën optime.pdf; R.2.h Procedurë për mbështetje financiare për kërkimin shkencor për botime në Scopus.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik, të angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. Rezultatet e punës kërkimore shkencore paraqiten në botime brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase. Metodatat interaktive të mësimdhënies përqendrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj. Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte kërkimi edhe në mbikqyrjen e praktikës mësimore, realizimi i të cilës</p>

	<p>mundësohet në sajë të kontakteve dhe bashkëpunimeve të Institucionit me institucionet publike dhe jo publike.</p> <p><i>Referenca: 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3.1.d Axhenda e trajnimeve e stafit akademik 2022-2023.pdf.; R.2.e Leksion i hapur "Mobility of Teaching" në kuadër të Erasmus+ KA131, Prof. Massimiliano Giacolone.pdf; R.2.f Trajnim me temë "Konceptet bazë për aplikime në projekte".pdf.</i></p> <p><i>Referenca: R2GRRE~1.PDF.PDF</i></p> <p><i>Reference: 3.11 Botim i stafit akademik në revistën optime.pdf; R.2.h Procedurë për mbështetje financiare për kërkimin shkencor për botime në Scopus.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 4.3 CV të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 1.10 Konferenca studentore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar disa instrumenta që përdoren për përmirësimin e veprimtarisë mësimore. Strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin si dhe njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si kontrolle të zhvillimit të mësimin, aplikimin e pyetsorëve dhe focus-grupet si instrument i vlerësimit të procesit të mësimdhënies, vlerësimit të performancës së stafit akademik në disa fusha, etj. Vëzhgimi nga afër i mënyrës së kryerjes së mësimin, vecanërisht për personelin akademik lektorë dhe asistentë lektorë, lejon të japin mendime e sugjerime, si dhe shkëmbejnë eksperiencat. Performanca e personelit akademik vlerësohet edhe duke marrë shqetësimet apo sugjerimet e studentëve nëpërmjet</p>



	<p>bisedave që realizohen në mbledhjet e hapura të ddepartamentit.</p> <p>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, rezulton se pyetëtori zhvillohet para përfundimit të çdo semestri dhe synon përfshirjen e të gjithë studentëve të programit, ndërsa focus-grupet përzgjedhja bëhet rastësore, për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj. GVJ konstatoi se zyra e NJSBC pasi përpunon të dhënat e mbledhura nga rezultatet e pyetësorëve, focus- grupeve dhe pyetësorët e pedagogëve ia vendos në dispozicion Departamentit i cili i diskuton në tërësi në mbledhjen e radhës. Rastet specifike, apo shqetësuese, diskutohen personalisht me personat e interesuar. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes emailit dhe ne Departament.</p> <p>GVJ sugjeron që institucioni të gjenerojë raportin me rezultatet e mbledhura nga instrumentat e monitorimit dhe vlerësimin të programit të studimit dhe personelit akademik.</p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 6.3.e Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë 2022-2023.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.; 3.5 Shembull raporti semestral.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.g Pyetesor personeli akademik v.a 2021-2022.pdf.pdf; 6.8.c Pyetësorët e personeli administrativ.pdf.; 6.8.f Pyetesoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf; 6.7.e Shkrese fokus-grupe 2022-2023.pdf.;</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimin të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. Referuar strukturave të sigurimit të cilësisë, rezulton se AU, ka ngritur Njësinë e</p>

<p>e vazhdueshëm të mësimit dhe bashkëpunimit me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimit dhe njësitë përgjegjëse mbështetëse eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimit, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimit dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>Sigurimit të Cilësisë në nivel IAL (sipas ligjit 802015), që kryejnë procedurat administrative për monitorimin e cilësisë, organizimin e pyetësorëve, focus grupeve, përpunimin e tyre dhe strukturat e njësive bazë dhe kryesore, të cilat ndjekin monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Këto struktura funksionojnë mbi bazë të statutit dhe rregullores së AU si dhe rregullores së NJSBC. Gjithashtu, Institucioni mundëson trajnime të ndryshme për personelin akademik që synojnë njohjen dhe përdorimin e metodave të reja në mësimit. Nga ana tjetër edhe pjesëmarrja në mobilitete sjell praktika të reja mësimit, të cilat ndahen dhe diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor në AU.pdf.; 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.pdf.; 6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 6.3.e Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë 2022-2023.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.; 3.5 Shembull raporti semestral.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.g Pyetësor personeli akademik v.a 2021-2022.pdf.pdf; 6.8.c Pyetësorët e personeli administrativ.pdf.; 6.8.f Pyetësoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimit online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf; 6.7.e Shkrese fokus-grupe 2022-2023.pdf.;</i></p> <p><i>Referenca: 3.1.b Axfenda e trajnimeve të stafit akademik - v.a. 2019 - 2020.pdf.; 3.1.c Axfenda e trajnimeve të stafit akademik 2021-2022.pdf.; 3.1.d Axfenda e trajnimeve të stafit akademik 2022-2023.pdf.; R.2.e Leksion i hapur "Mobility of Teaching" në kuadër të Erasmus+ KA131, Prof. Massimiliano Giacalone.pdf; R.2.f Trajnim me temë "Konceptet bazë për aplikime në projekte".pdf.</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi</i></p>
---	---

	<i>me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore.</i></p> <p><i>Fusha e ekspertizës dhe kërkimore shkencore e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënien në programin Bachelor në "Menaxhim Biznesi" është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. GVJ sugjeron që institucioni të gjenerojë raportin me rezultatet e mbledhura nga instrumentat e monitorimit dhe vlerësimit të programit të studimit dhe për personelin akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Vizita në instucion, veçanërisht diskutimi me studentët konfirmoi vlerësimin se të gjitha kriteret dhe rregullat e mënyrat e testimit janë të njohura në sajë të publikimit në faqen e institucionit të planit mësimor, në syllabusin e lëndës si edhe informimit e sqarimit nëpërmjet strukturave të institucionit. GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve është i vazhdueshëm duke përfshirë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, provimi final i lëndës dhe provimi i përgjithshëm i formimit/mbrojtjediplome.

	<p><i>Referenca: Referenca: 1.1.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; 1.1.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.</i></p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Kreu V); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu III, IV & V)</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në vijim të informacionit të dhënë tek kriteri 1 i këtij standardi, GVJ vlerëson se pedagogët i informojnë studentët në fillim të procesit mësimor me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulin përkatës. Gjithashtu programet e lëndëve, përfshirë edhe elementët e mësipërm janë pjesë e publikimit të secilit pedagog, në faqen përkatëse të sistemit të menaxhimit të të dhënave PITAGORA. Përveç sistemit, institucioni për komunikim interaktiv dhe zhvillim të mesimit on-line, ka përdorur platformën elektronike të Microsoft Teams.</p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p> <p><i>Referenca: 3.2 Klasë në Microsoft Teams.pdf.; 3.3 Shembull pyetësori i plotësuar në Microsoft Teams.pdf.; 3.4 Manuali i Përdorimit të Platformës TEAMS.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstatoi se në Rregulloren e Fakultetit dhe atë të programit të studimit, përcaktohen qartë se format e kontrollit të dijeve janë komplekse dhe të larmishme, përkatësisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivizimi në mësim • Provim i ndërmjetëm. • Detyrat e kursit, punë grupi, prezantime ose ese. • Provim i përfundimtar.

	<p>Studentët njihen qysh në fillim të semestrit me mënyrën e kontrollit të dijes dhe formën e organizimit të saj, në secilin modul. Sistemi i pikëzimit dhe i vlerësimit mbi bazën e pikëzimit është gjithashtu i standardizuar dhe i përcaktuar.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Kreu V); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu III, IV & V)</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mënyra e përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies bëhet nëpërmjet mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve si nga Njësia bazë, por edhe nëpërmjet metodologjive që implementon NJSBC, të cilat u shpjeguan në Standardin III.1, kriteri 5.</p> <p><i>Referenca: 6.9 Rregullore NJSBC.pdf.pdf6; 6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 - 2025.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 6.3.e Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë 2022-2023.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 2.5 Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf.; 6.3.a VS - SC në nivel Departamenti - 08 09 2016.pdf.; 1.c Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.; 3.5 Shembull raporti semestral.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.g Pyetesor personeli akademik v.a 2021-2022.pdf.pdf; 6.8.c Pyetësorët e personeli administrativ.pdf.; 6.8.f Pyetesoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf; 6.7.e Shkresë fokus-grupe 2022-2023.pdf.;</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>AU trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, AU ka në dispozicion i laborator informatike dhe sallën e bibliotekës të pajisura me programe kompjuterike bashkëkohore, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike. Departamenti angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.</p> <p><i>Referenca: 3.1.b Axhenda e trajnimeve te stafit akademik - v.a. 2019 – 2020.pdf.; 3.1.c Axhenda e trajnimeve të stafit akademik 2021-2022.pdf.; 3.1.d Axhenda e trajnimeve e stafit akademik 2022-2023.pdf.; R.2.e Leksion i hapur "Mobility of Teaching" në kuadër të Erasmus+ KA131, Prof. Massimiliano Giacalone.pdf; R.2.f Trajnim me temë "Konceptet bazë për aplikime në projekte".pdf.</i></p> <p><i>Referenca: R2GRRE~1.PDF.PDF; 3.11 Botim i stafit akademik në revistën optime.pdf; R.2.h Procedurë për mbështetje financiare për kërkimin shkencor për botime në Scopus.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: R.1 Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore Bulevardi "Zogu I".pdf.</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucioanl agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.; R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra</i></p>

	<i>e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe janë të njohura nga të gjithë studentët. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Dokumentacioni rregullator si edhe syllabuset e çdo lënde përcaktojnë qartë mënyrën e vlerësimit të studentit, e cila bazohet në vlerësimin e studentit në mënyrë të vazhduar. Vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra apo ese) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit).</p> <p>Raporti ndërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit (Neni 25). Është kompetencë e pedagogut që të informojë studentët, të cilët duhet të njohin jo vetëm mënyrën por edhe nivelin e përgjithshëm të pikëve paraprake, përpara se sa të përfundojë kursi përkatës. Vizita në institucion tregoi se nuk ekzistojnë paqartësi apo konflikte për këtë çështje.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (Kreu V); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu III, IV-Neni 25 & V)</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme	GVJ konstatoi mbështetjen e Institucionit për të inkorporuar në të ardhmen sisteme elektronike të testimit online. Gjatë

<p>elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>periudhës së pandemisë Institucioni ka përdorur metoda të vlerësimit online për rezultatet e të nxënit. Këto metoda kanë përfshirë teste elektronike dhe quize online për përvetësimin e koncepteve kryesore të lëndëve si dhe portofolin digital që ka përfshirë bibliografi dhe Ëebliografi, ese apo ushtrime dhe detyra kursi, sipas programit lëndor.</p> <p><i>Referenca: 3.2 Klasë në Microsoft Teams.pdf.; 3.3 Shembull pyetësi i plotësuar në Microsoft Teams.pdf.; 3.4 Manuali i Përdorimit të Platformës TEAMS.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Siç është përmendur edhe në kriteret e mësipërme, vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (aktivizimi në mësim, provim i ndërmjetëm dhe detyra kursi apo ese) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit, saktësuar në syllabuset e çdo moduli). Ashtu siç e përcakton edhe ligji për arsimin e lartë modulet e programit të studimit janë të vlerësuara në kredite (ECTS), të cilat student i fiton pasi ka marrë një vlerësim pozitiv të vlerësimit përfundimtar.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Kreu V); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu III, IV & V)</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar dhe përmbyllës i çdo moduli njohurive shoqërohet me komente dhe argumentim për të ndihmuar studentin të kuptojë situatën e të nxënit dhe të përmirësohet. Studentët gjithashtu gëzojnë të drejtën e ankimit, pasi njihen me rezultatet e provimeve. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme.</p>



<p>ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Kreu V); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf.pdf (Neni 22); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu III, IV & V)</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën. Së pari, personeli i ngarkuar me mbikqyrjen e provimit zbaton tërësisht rregulloren. Së dyti, komisioni i ngarkuar për vlerësimin jo vetëm zbaton rregulloren por ndërmerr edhe masa ndëshkimore në rast të shkeljes së saj. Kodi i Etikës, gjithashtu përcakton si elemente që përbëjnë shkelje disiplinore, plagjiaturën dhe kopjimin dhe masat që ndërmerren.</p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e pergjithshme.pdf.(Neni 57, pika 3d); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Neni 23)</i></p> <p><i>Referenca: 6.10 Kodi i Etikes.pdf.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në rregulloret përkatëse, përgjegjësi i departamentit kontrollon dhe miraton tezën, mbi bazën e të cilës kontrollohen dhe vlerësohen njohuritë dhe dijet e përfituara. Teza duhet të përfshijë të gjitha informacionet thelbësore të diskutuara në klasë gjatë zhvillimit të modulit. Gjithashtu, veprimet dhe detyrimet pas përfundimit të provimit dhe kontrollit të tij, janë të përcaktuara në rregullore. Fleta e vlerësimit të provimit përmbillet dorëzohet në Sekretari e plotësuar nga kryetari i komisionit ose pedagogu i lëndës jo më vonë se një javë ditë nga dita e kryerjes së provimit. GVJ gjykon që institucioni përdor të gjitha instrumentat efektivë që të garantojë rezultate të bazuara mbi meritokracinë.</p> <p><i>Referenca: 1.3 Rregullore e pergjithshme.pdf.(Neni 52, pika 6 & 14); 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 40, pika 7 & pika 15);1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Neni 19 pika 5 & 13)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e</p>	<p>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me</p>

<p>studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet, brenda dy ditëve (48 orë) nga shpallja e rezultatit të vlerësimit. Në rast reklamimi Dekani i Fakultetit ngreh një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit marrin pjesë edhe pedagogu apo pedagogët që kanë vlerësuar tezën, Vendimi në lidhje me kërkesën për rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni apo pedagogu i lëndës ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Neni 24)</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërjegjshme. Vlerësimi përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (1) lëndë bazë, (2) lëndë të formimit karakterizues (3) lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, (4) lëndë plotësuese</p>

	<p>përfshihet vetëm praktika profesionale dhe në detyrimet përmbyllëse përfshihet provimi i përgjithshëm formimi. Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për të fituar aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit. <i>Megjithatë programi duhet të garantojë më tepër njohuri dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të biznesit dhe jo duke u fokusuar dhe profilizuar në drejtimin financiar.</i></p> <p>GVJ konsideron deri diku të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i></p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.; Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Plani Mësimor siguron informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar se program i studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji (Informatikë), shkencë humane dhe shoqërore (E Drejtë Biznesi), si dhe komunikimit dhe ndërveprimit (Kumunikimi në Biznes), <i>por ka ende mundësi për përmirësime në zhvillimin e këtyre aftësive duke përfshirë lëndë si Sociologji, Sjellje Organizative, Etikë Biznesi etj.</i></p> <p>Veçanërisht me vlerë është organizimi dhe realizimi i praktikës profesionale në institucione, organizata dhe ndërmarrje publike dhe jo publike.</p> <p><i>Referenca: 2.1 Kurrikula e programit të studimit.pdf.; Tabelat Aneks RVB- BSc. Menaxhim Biznesi.pdf., Tabela 9, fq. 14-15</i></p> <p><i>Referenca: 1.9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të pyetësorit të studentëve dhe focus grupeve, diskutimeve me</p>

<p>syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Tregues statistikorë të mbledhur nga institucioni, që reflektojnë ecurinë e studentëve, gjithashtu konsiderohen për të argumentuar efektivitetin e programit të studimit. Në përfundim të çdo moduli dhe semestri, pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p><i>Referenca: Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.; 3.5 Shembull raporti semestral.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 6.8.g Pyetesor personeli akademik v.a 2021-2022.pdf.pdf; 6.8.f Pyetesoret e studenteve 2021-2022.pdf.; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021.pdf.; 6.7.c Shkresë fokus-grupe 2020-2021.pdf.; 6.7.d Shkresë fokus-grupe 2021-2022.pdf.; 6.7.e Shkrese fokus-grupe 2022-2023.pdf.;</i></p> <p><i>Referenca: 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 1.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 2.pdf.pdf; 2.2 Syllabuse BSC MB VITI 3.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve</p>	<p>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit.</p> <p>Një nga mënyrat e vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së përgatitjes të një detyre kursi, të vlerësuar me 10 % të vlerësimit përfundimtar, në varësi nga specifikat e modulit si edhe vendimi i pedagogut përkatës. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për punën e temës së diplomës. Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet</p>

<p>inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>idetë innovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Njësia, nga ana tjetër i krijon studentëve mundësi në përfshirjen e tyre në kërkime shkencore dhe aktivitete shkencore. Gjithashtu Institucioni është vazhdimisht aktiv në programin e këmbimeve akademike dhe kulturore, Erasmus.</p> <p><i>Referenca: 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB;</i> <i>Referenca: Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.;</i> <i>Referenca: 1.10 Konferenca studentore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: R.2.a Erasmus + Programme Inter-Institucionale agreement KA1 mes Uni.Salento dhe AU.pdf.pdf; R.2.c Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Europës Juglindore, Tetove.pdf.;</i> <i>R.2.d Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë bën përpjekje intensive që të ofrojë të reja më të përditësuara të shkencës dhe teknologjisë si nëpërmjet leksioneve të hapura ashtu edhe organizimit të seminareve. Në periudha të ndryshme vitit janë realizuar disa leksione të hapura me pjesëmarrje të ekspertëve të njohur të vendit. Në këto aktivitete gama e çështjeve të trajtuara paraqitet e larmishme.</p> <p><i>Referenca: Raporti vjetor për vitin akademik 2021-2022.pdf.</i> <i>Referenca: 2.8 Leksione të hapura.pdf.pdf; 5.6 Leksion i hapur "Si të punësohesh".pdf.;</i> <i>5.7 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konsideron deri diku të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</p> <p><i>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale</i></p>



	<i>iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit. Në leksionet e hapura që IAL organizon janë trajtuar disa tema me rëndsi për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit (Neni 41), të Departamentit (Neni 23) dhe të programit të studimit (Kreu V), përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”. Për t’u diplomuar studenti duhet t’i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, i cili përfshin çështje kryesore të moduleve të realizuara gjatë zhvillimit të programit. Kjo me përjashtim të studentëve me mesatare të ponderuar mbi 7.5 të tre viteve të studimit të cilët mund të zgjedhin punim diplome.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf. (Neni 23); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p> <p><i>Referenca: 3.7 Lista e temave të diplomave.pdf.pdf; 3.8 Fondi i pyetjeve të provimit të formimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione dhe udhëzime për materialet e nevojshme që duhet të konsultojnë në përgatitjen e provimit final. Në fillim të vitit të tretë studentëve i vendoset në dispozicion një program orientues për provimit final, ndërsa sesionet e konsultimit realizohen gjatë gjithë vitit akademik. Për studentët të cilët diplomohen me temë diplome, përveç fushave të ekspertizës së pedagogëve dhe temat orientuese, sistema i komunikimit me pedagogun udhëheqës është</p>

	<p>fleksibël dhe realizohet nëpërmjet seancave javore këshillimore dhe tutoriatit online.</p> <p>Udhëzuesi i përgatitjes së temës së diplomës është një dokument me vlerë për orientimin e studentëve, për vendosjen dhe respektimin e standardeve akademike të punimit të diplomës, për standardizimin e procesit të temës së diplomës për stafin dhe studentët në tërësi.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf. (Neni 23); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p> <p><i>Referenca: 3.7 Lista e temave të diplomave.pdf.pdf; 3.8 Fondi i pyetjeve të provimit të formimit.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi përfundimtar i formimit teston njohuritë e fituara nga studenti nga grup lëndët e formimit karakterizues. Në fillim të vitit të tretë studentëve i vendoset në dispozicion një program orientues për provimit final së bashku me literaturën e nevojshme, e cila depozitohet në departament. Ndërsa sesionet e konsultimit realizohen gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Teza e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar hartohet dhe korrigohet nga drejtuesit e grupeve mësimore nën mbikëqyrjen e përgjegjësit të departamentit, të cilët përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar i pyetjeve. GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf. (Neni 23); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p> <p><i>Referenca: 3.8 Fondi i pyetjeve të provimit të formimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>



<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Procedura për monitorimin, ndjekjen dhe udhëzimet e punimit të diplomës janë të shpjguara në dokumentat: Rregullore e Fakultetit, Rregullore e Departamentit, Rregullore e Programit të studimit si dhe në udhëzuesin për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf. (Neni 23); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p> <p><i>Referenca: 3.7 Lista e temave të diplomave.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga takimi i realizuar me studentët dhe stafin akademik rezulton se njësia bazë asiston dhe ndihmon studentët për kryerjen e analizave si në mjediset brenda IAL dhe jashtë saj.</p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit dhe ajo e brendshme e programit të studimit përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të studentit pas përfundimit të detyrimeve përmbyllëse. Si mbrojtja e diplomës dhe e provimit përfundimtar realizohet përpara një komisioni të përbërë nga 3-5 anëtarë, pedagogë të këtij program studimi, të cilët propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani. Gjithashtu, studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës apo të hyjë në provimin përfundimtar pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Komisioni i ngritur për vlerësimin e studentëve në provën finale vlerëson me notë studentin sipas sistemit të vlerësimit të përcaktuar nga Institucioni.</p> <p><i>Referenca: 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.6 Rreg.Dep.Shkencave Ekonomike.pdf. (Neni 23); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p>

	<p><i>Referenca: 3.7 Lista e temave të diplomave.pdf.pdf; 3.8 Fondi i pyetjeve të provimit të formimit.pdf.</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha detyrimet e planit mësimor dhe ka mbrojtur me sukses provën finale (provim formimi ose punim diplome) pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës. Modeli i diplomës është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Në përfundim të studimeve, me kërkesë të studentit, mund të vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca; 1.3 Rregullore e pergjithshme.pdf. (Neni 55)1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave te Aplikuara dhe Ekonomike (Neni 41); 1.4 Rregullore e programit të studimit BSc.MB (Kreu V)</i></p> <p><i>Referenca: 3.13 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf. (Neni 12)</i></p> <p><i>Referenca: 3.12.a Model i diplomës BSc në Menaxhim Biznesi.pdf.; 3.12.b Model i suplementit të diplomës.pdf.; 3.12.c Model i listës së notave.pdf.pdf</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretarise mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p> <p><i>Referenca: 3.13 Rregullore e sekretarise mesimore.pdf. (Neni 12)</i></p> <p><i>Referenca: 3. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj</i></p>

	<p>për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimi të tyre.</p> <p>Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2020-2023 është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë nga të cilët 14 PAE (2 Prof.As. 7 Dr. 5 Msc.) dhe 8 PAK (1 Prof.Dr. 2 Prof.As. 1 Dr. dhe 4 Msc.) 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 17 pedagogë nga të cilët 9 PAE (2 Prof.As. 4 Dr. dhe 3 Msc.) dhe 8 PAK (2 Prof.As. 4 Dr. dhe 2 Msc.)

	<p>3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 21 pedagogë nga të cilët 13 PAE (2 Prof.Dr. 2 Prof.As. 4 Dr. dhe 5 Msc.) dhe 8 PAK (1 Prof.Dr. 1 Prof.As. 3 Dr. dhe 3 Msc.)</p> <p>Në raportin e vetëvlerësimit por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion AU reflekton gadishmërinë e angazhimit të gjithë personelit akademik, ndihmës akademik, mësitor dhe administrativ në përputhje me objektivat e programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi”. Nga Evidencat dhe dokumentacioni shoqërues rezultojnë të figurojnë staf PAE njëkohësisht Përgjegjës i Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>Nga vizita në institucion por edhe nga diskutimi me stafin efektiv GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është dominante dhe me prirje financë kontabiliteti e cila nuk është shumë në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.</i></p> <p><u>Referenca</u></p> <p><i>Vizita në Institucion; Kurrikula e programit të studimit; CV të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Procedura rekrutimi stafi akademik; Tabelat Aneks RVB-BSc. Menaxhim Biznesi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion për tre vitet e fundit akademike, kemi këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pwr vitin akademik 2020-2021 orët rezultuan 1369 orë ose 69 % e orëve në auditor ka rezultuar të mbulohet nga personel akademik efektiv PAE ndërsa nga stafi akademik me kontratë PAK janë realizuar për këtë vit 617 orë të realizuara ose 31 %. - Për vitin akademik 2021-2022 orët e realizuarar nga staf akademik efektiv PAE rezultojnë të jetë 1281 orë ose 68.6% të totalit, ndërsa nga stafi akademik me kontratë PAK 587 orë ose 31.4%. - Ndërsa për vitin e fundit akademik 2022-2023, totali i orëve të realizuara 1764 respektivisht 1200 orë mësimore, ngarkesë e realizuar nga staf akademik

efektiv PAE ose 68 % dhe 564 orë mësimore nga staf akademik me kontratë PAK ose 32%.

Nga sa më lartë ngarkesa mësimore për këtë program studimi, për tre vitet u fundit nuk është realizuar mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: "Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi", në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit. Rekomandojmë që stafi akademik PAE të mbulojë mbi 70 % të ngarkesës mësimore të programit të studimit.

Megjithatë nuk mund të mos reflektohet situata e ngarkesës së stafit akademik të njësisë që mbulon programin e studimit që po i nënshtrohet procesit të akreditimit i cili vijon si me poshtë.

Bazuar në dokumentacionin që shoqëron dosjen e vetëvlerësimit respektivisht (Tabela 4. Aneks Tabelat Përmbledhëse, fq. 7-8). Paraqitet **ngarkesa totale përfshirë të gjitha programet** e personelit akademik të Departamentit të Shkencave Ekonomike në vitin akademik 2022-2023. Evidentohen një tepricë e madhe orësh të realizuara në auditor nga Pedagog Akademik Efektiv PAE, ku respektivisht Prof. Asoc. S.M. ka realizuar 660 orë fizike në auditor të realizuara nga 8 Lëndë. Dr. G. Ç. ka realizuar 569 orë fizike në auditor të realizuara nga 9 lëndë.

Gjithashtu edhe Prof. Asoc. M. M. rezulton sipas kësaj evidence të ketë realizuar 8 lëndë me 432 orë fizike në auditor. Kjo situatë e shpërndarjes së orëve por edhe e lëndëve bie ndesh me Udhëzimin Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot. Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. II Ngarkesën Mësimore Vjetore për Personelin Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. Pika 6. Ku thotë: Ngarkesa e plotë mesimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbaje në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore.

Në takimet e realizuara me personelin akademik efektiv të Departamentit të Shkencave Ekonomike u konstatua se në reflektimet e ngarkesave kishte pasaktësi në korespondim të stafit me lëndët respektive të realizuara. Duke diktuar nevojën e saktësisimit të qartë të ngarkesave vjetore sipas Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe atij me Kontratë (PAK).

	<p><i>Referenca: Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB-BSc. Menaxhim Biznesi (Tabela 4. Fq.7-8); Udhëzimin Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar dokumentacionit por edhe gjithashtu vizitës në institucion AU. GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin BSc. "Menaxhim Biznesi". Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Ndryshimi i konstatuar në stafin akademik efektiv rezultoi rreth 5%.</p> <p><i>Referenca: Tabelat Përmbledhëse Aneks RVB-BSc; Kontratat PAE; Kontratat PAK; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni mbështetës paraqet qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim të AU, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës.</p> <p><i>AU si edhe DSHE duhet të ketë në konsideratë evitimin e praktikave të rekrutimit si staf PAE në këtë program studimi, punonjës ekzistues madje me funksione drejtimi si rasti i konstatuar në Kriterin 1. Ku Përgjegjësjë e Zyrës së Burimeve Njerëzore rezultoi PAE me 2 lëndë në BSc.MB.</i></p> <p><i>Referenca: Procedura rekrutimi stafi akademik; CV të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Vendim senati për procedurat e rekrutimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e</p>	<p>GVJ konstatoi që DSHE ka staf ndihmës për departamentin duke përfshirë dhe asistenten e angazhuar në punët administrative. Gjithashtu pjesë e stafit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike të cilët asistojnë në ambientet e laboratorëve, të cilët përdoren nga stafi akademik sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB-BSc.; Vizita në Institucion.</i></p>

<p>laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe nga vizita në institucion, me përgjegjës degën e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin Bachelor në Menaxhim Biznesi.</p> <p><i>Megjithëse dokumenti i CV-ve të stafit PAE nuk rezultoj të ishte i plotë dhe i azhonuar me ndryshimet e fundit të promovimit në tituj shkencor të stafit akademik.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon Përgjegjësin e Departamentit, të mbledhë, përditësojë dhe arkivojë çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik të cilët mungonin në dokumentin shoqërues të RVB-së.</i></p> <p><i>Referenca: CV të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU në nivel institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Biznesi praktika profesionale. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga AU me institucione dhe biznese kombëtare e ndërkombëtare. GVJ konfirmoi këto procese dhe nga takimi me studentët e programit.</p> <p><i>Referenca: Marrëveshjet e bashkëpunimit me Universitetin e Europës Juglindore Tetovë; Marrëveshje për shkëmbim stafi me Higher School of Insurance and Finance VUZF Bullgari; Vizita në Institucion.</i></p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i departamentit duke qënë se janë të angazhuar dhe punojnë në biznese të rëndësishme në vend ata angazhohen në ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve të programit. Gjithashtu ato realizojnë vizita në ambientet e praktikave dhe takime me studentët për ti orientuar në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës. Stafi supervisor i praktikave është gjithashtu pjesë në procesin e vlerësimit të tyre në fund.</p> <p><i>Referenca: Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ pasi ka konstatuar praktikën e AU për angazhimin në programin BSc, MB të personelit administrativ. GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar konstatoi nevojën e përditësimit të CV-ve të stafit që u mungonte ky dokument. Gjithashtu dhe sidomos në funksion të azhornimit të titujve të fundit të fituar nga Stafi i programit BSc, MB. Rezultoj gjithashtu se Staf efektiv Administrativ është njëkohësisht edhe staf PAE në Departamentin e Shkencave Ekonomike. Konkretisht, Përgjegjësja e Zyrës së Burimeve Njerëzore rezulton PAE me 2 lëndë në BSc.MB. Gjykojmë se praktika të tilla nga AU duhen rishikuar pasi mund të krijojnë konflikt interesi jo vetëm në kufijtë ligjor, duke ndikuar në raportet e institucioneve brenda AU-së, e si pasojë duke ndikuar edhe në cilësinë e Programit BSs, MB. E si pasojë duke ndikuar edhe në raportin PAE/PAK, si edhe të ngarkesave mësimore respektive të cilat diktohen nga kuadri ligjor në fuqi.</i></p> <p><i>Sipas Evidencave rezultojnë pedagogë me 8 dhe 9 Lëndë të realizuara me një total prej 569 dhe 660 orësh. Korniza ligjore në fuqi, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot. Dikton numër shumë më të kufizuar lëndësh për pedagog PAE, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të ofruara nga ky staf akademik.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për përmirësimin e shpërndarjes së ngarkesës së orëve në auditor të stafit PAE me qëllim përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bsc "Menaxhim Biznesi" në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Ekonomike zhvillon procesin mësimorë në godinën qendrore të AU në Bulevardin Zogu i I. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin Bachelor në Menaxhim Biznesi janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. GVJ konstatoi se AU ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat; Planimetria e Godinës; Mjediset e AU; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sallat që përdoren gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet (<i>me përjashtim të një numri shumë të kufizuar të kompjuterave desktop pc në dispozicion të studentëve, në bibliotekën e AU-së, duke konsideruar se AU ka vënë në dispozicion një bibliotekë online multifunksionale të pasur me ABSCO, ERIC-Education Resources Information Center, Cambridge Journals</i>). Në godinën e përdorur nga DSHE ofrohen dhe zyrat e stafit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimorë.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Mjediset e AU Vizita në Institucion.</i></p>

<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>DSHE bazuar në rekomandimet e lëna nga procesi i fundit i Akreditimit nga ASCAL lidhur me rritjen e kapaciteteve laboratorike e kompjuterike në dispozicion të programit, departamenti sot ka siguruar nje laborator te pajisur me mjete brenda standardeve në përmbushje të kërkesave të programit dhe arritjen e objektivave të tij.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Mjediset e AU ; Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>AU, i cili ofron programin Bachelor në Menaxhim Biznesi ofron për studentët laboratorin e Informatikës i cili konsiston në një sallë me 25 kompjutera e cila shfrytëzohet për realizimin e lëndëve “Informatikë”, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit”, “Statistikë”, “Kontabilitet Financiar”. Laboratori ofron pajisjet e duhura teknologjike dhe programet standarde dhe specifike si “Microsoft Office” dhe “Financa 5” të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe të përshtatshme sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Mjediset e AU; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht pasi bazuar në dokumentacionin e vlerësimit dhe në vizitën në institucion është konstatuar që AU ka në dispozicion të Programit BSc. MB. mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore. Megjithatë duhet theksur këtu nevoja e pasurimit me mjete kompjuterike desktop pc, në mjedisin e bibliotekës, pasi AU ka vënë në dispozicion një bibliotekë online e-book multifunksional të pasur me ABSCO, ERIC-Education Resources Information Center, Cambridge Journals.</i></p> <p><i>Përmirësimi i mjedisit të studimit të studentëve ndihmon në përshtatshmërinë për zhvillimin e aktiviteteve, kërkimore dhe të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit kërkimor por edhe mësimorë.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri te studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Titujt e librave në bibliotekë; Procedurë e pasurimit të bibliotekës.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në bibliotekën e fakultetit gjendet një numër i rëndësishëm tekstesh mësimore në total në dispozicion te DSHE. Megjithatë vërehen nevoja e pasurimit me literaturë të përditësuar. <i>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës së viteve të fundit dhe sa më bashkëkohore.</i> <i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Titujt e librave në bibliotekë; Procedurë e pasurimit të bibliotekës.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin që shoqëron RVB-në dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se AU vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën e cila mundëson 1 sallë leximi ambiente studimi dhe sociale të shfrytëzueshme për aktivitetet kërkimorë dhe veprimtari promovuese. <i>Referenca: Hapësira për student në ambientin e bibliotekës; Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se studentët e AU_së kanë akses dhe

<p>fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>në bibliotekën online e-book multifunksional të pasur me ABCO, ERIC-Education Resources Information Center, Cambridge Journals. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p><i>Referenca: Hapësira për student në ambientin e bibliotekës; Titujt e librave në bibliotekë; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit, që Biblioteka ofron informacione online nga burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë të AU.</p> <p>Biblioteka Universitare Shkencore siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë.</p> <p><i>Por konstatoam një numër shumë të kufizuar kompjuterash, dhe sigurisht do ta rekomandojmë nevojën për rritjen e numrit të vendeve për një aksesueshmëri me të madhe njëkohësisht si nga studentët por edhe nga stafi akademik.</i></p> <p><i>Referenca: Hapësira për student në ambientin e bibliotekës; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të cilat u vihen në dispozicion dhe u vijnë në ndihmë studentëve. Por për shkak të rolit gjithmonë e më shumë në rritje të bibliotekës online që AU ka vënë në dispozicion të frekuentuesve të bibliotekës pak mjete kompjuterike. Ky numër mjeteve kompjuterike në mjedisin e bibliotekës së AU, është shumë i limituar në dispozicion të studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon domosdoshmërinë e rritjes së kapacitetit dhe mjeteve kompjuterike nërmjet desktop-ëve, pc, etj në dispozicion të përdoruesve të bibliotekës. Në mënyrë që biblioteka on line të mund të aksesohet nga sa më shumë studentë në funksion të përgatitjes së tyre për detyrimet e lëndeve por edhe për punët kërkimore.</i></p> <p><i>Referenca: Hapësira për student në ambientin e bibliotekës; Vizita në Institucion.</i></p>

<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi që biblioteka e AU operon dhe ofron shërbim studentëve çdo ditë të javës 8.00-16.00, duke përfshirë dhe ditën e Shtunë 8.00-12.00, në mënyrë që shërbimi për studentët të jetë jo vetëm në oraret e tyre sipas programeve të studimeve por edhe e pandërprerë.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Titujt e librave në bibliotekë; Procedurë e pasurimit të bibliotekës; Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në RVB, dhe në dokumentacionin e ofruar dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që Departamenti i Shkencave Ekonomike, përgjegjëse për programin e Bachelor në Menaxhim Biznesi, në periudha të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi. Kjo nevojë i referohet edhe sidomos rishikimit të syllabuseve që bën departamenti që administron programin.</p> <p><i>Referenca: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm; Titujt e librave në bibliotekë; Procedurë e pasurimit të bibliotekës.</i></p> <p><i>Fondi fizik i evidentuar nga vizita në institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programit Bachelor në Menaxhim Biznesi. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</i></p> <p><i>Por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës më dinamike si dhe për shkak se AU ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën on line mjedisi i Biblioteksës duhet të jetë i kompjuterizuar në përshtatje e dispozicion të një numri</i></p>



	<i>të madh studentësh. Në mjedisin aktual identifikohen vetëm 2 kompjutera në dispozicion të përdoruesve të bibliotekës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se Sekretaria e AU-së është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dy dosje të zgjedhura të studentëve në programin Bachelor në Menaxhim Biznesi, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi në përdorim është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>Referenca: Platforma Pitagora; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin Bachelor në Menaxhim Biznesi menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Njerëzore. Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e programit ruhen në Departament dhe në zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes për Studentët, Zyra e Marrdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike etj.</p> <p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë AU: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p>

për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<i>Referenca: Platforma Pitagora; Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e AU, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi përdor dhe platformat të tjera si Office 365 apo emaile zyrtre si metoda interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programet e lëndëve. <i>Referenca: Platforma Pitagora; Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në funksion të këtij Kriteri në RVB, nuk ka asnjë shpjegim apo informacion përshkruar nga GVB. GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të AU garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <i>Referenca: Platforma Pitagora; Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të Institucionit AU jepen dhe publikohet në gjuhën shqipe, angleze si edhe italiane i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. <i>Referenca: Kontrolli i web_it të Institucionit.</i>			
Konkluzione	<i>AU përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të AU. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet etj të AU publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe, angleze si edhe italiane.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	----------

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Ekonomike ka një pjesë të veçantë në strukturën e buxhetit për AU pjesë kjo e Shoqërisë UFO shpk.</p> <p>AU akordon një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar ku është përcaktuar gjithashtu plani për mbarëvajtjen e programit të studimit. Ky plan financiar i cili përlllogarit kostot e mbulimit të ciklit të plotë të studimit por edhe tarifat dhe pagesat studentore, hartohet nga AU. Bordi i Administrimit të AU përcakton kriteret mbi të cilat do hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se institucioni harton raportin e analizës financiare për të evidentuar masën e realizimit të të ardhurave si edhe nivelin e realizimit të shpenzimeve në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar, rregullave të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin Nr. 9901, date 14. 4. 2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në Ligjin Nr. 9228, date 29.4.2004” Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Rregullore e Përgjithshme</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>



të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ konstatoi nga RVB se AU bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. Institucioni gjithashtu auditohet çdo vit nga audit i brendshëm duke pasur për mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ konstatoi nga RVB se AU paraqet çdo vit akademik analizën vjetore për të gjithë veprimtaritë e kryera, pasqyrën financiare të lidhur me gjendjen, angazhimin e personelit, tarifat etj. Organet më të larta drejtuese të AU përgatisin vlerësimin financiar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar që më pas të mundësojnë planifikime dhe ndërhyrjet e nevojshme në mbarëvajtjen e programeve të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	AU është pjesë e Shoqërisë UFO shpk, si e tillë GVJ konstatoi se asaj i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat sidomos duke ju referuar situatës së qëndrueshme financiare dhe bankare, bazuar në programin financiar ku është përcaktuar gjithashtu plani për mbarëvajtjen e programit të studimit. Përdorimi i fondeve nga AU bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e vëna të realizimit të programeve të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Konkluzione	<i>AU harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i</i>



	<i>nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe raportet përcillen nga Bordi i Administrimit deri në njësinë bazë. Situata financiare dhe bankare e AU dëshmon dhe garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e AU, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e AU specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Referenca: Statuti AU; Rregullore E Përgjithshme; Rregulloret e Programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	Në funksion të këtij Kriteri në RVB, <u>nuk ka asnjë shpjegim</u> apo informacion përshkrues nga GVB. Por GVJ bazuar në Statutin dhe Rregulloret e AU, GVJ vlerëson se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantoohen si edhe nga rregullorja e programit.

<p>studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>Referenca: Statuti AU; Rregullore e programit te studimit; Rregullore e përgjithëshme</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe pas vizitës së realizuar në institucion konstatojme se IAL, harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në AU, Departamentet propozojnë kriteret e pranimit për çdo program studimi që mbulojnë si dhe kriteret që do përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Drejtuesi i njësisë bazë dorëzon vendimin e departamentin për kriteret e propozuara tek njësia kryesore e cila ia përcjell drejtuesve të IAL-së së institucionit. Kriteret e propozuara u vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Në vijim lista me kandidatët e përzgjedhur i përcillet për miratim Senatit Akademik dhe më pas publikohet ne faqen zyrtare të Albania University si dhe afishohet në tabelen e njoftimeve pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore.</p> <p><i>Referenca: Vendimi i senatit për miratimin e kuotave të pranimit; Panairi Eork & Study; Udhëzues Orientues për Maturantët</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se AU bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimeve jep informacione mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, vlerësimit të dijeve përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, ku janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Referenca: Rregullorja e programit të studimit Bsc. MB</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se AU fillon informimin e maturanëve gjatë ditëve të informimit të organizuar nga MAS. Dhe më pas, në vazhdim, për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron, me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret e pranimit në to.</p>



përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<i>Referenca: Panairi Work & Study; Udhëzues Orientues për Maturantët</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se AU ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Bachelor Menaxhim Biznesi nuk përjashton mundësinë e integritit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Kriteret miratohen në Senat.			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstatoi se AU përcakton procedura përpara fillimit të çdo viti akademik. Duke hartuar kritere të pranimit për të gjithë kategoritë e aplikantëve. Në kuadrin rregullator të AU parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit për të gjitha kategoritë e studentëve. Këto kritere miratohen me Vendim të Senatit Akademik, i pëcillen për dijeni Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve si edhe publikohen në faqen zyrtare të AU-së. <i>Referenca: Vizita në institucion; Rregullorja e programit të studimit Bsc. MB</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstatoi se AU duke ndjekur kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët që i përkasin shtresave në nevojë dhe atyre kategorive të veçanta. <i>Referenca: Vizita në institucion; Statuti; Rregullore e përgjithëshme.</i>			
Konkluzione	<i>Në kuadrin rregullator të AU parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet bachelor, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. AU ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV si edhe, informacionit të siguruar nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por AU aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve.</p> <p><i>Referenca: Statuti; Rregullore e programit të studimit Bsc. MB; Platforma Pitagora; Vizita në Institucion; Rregullore e përgjithëshme.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>GVJ konstatoi se AU përmes sekretarive të programeve të ciklit të parë dhe bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve-VS 25-dt.25.06.2020, informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informimi për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme në Programin Bachelor “Menaxhim Biznesi” mund të sigurohet drejtpërdrejtë ose me kërkesë të të interesuarit tek njësia përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit.</p> <p><i>Referenca: Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve-VS25-dt.25.06.2020, Vizita në Institucion.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni shoqërues dhe vizita me studentët, se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në</p>



<p>studentëve në programin e studimit.</p>	<p>platformen Pitagora dhe prezantimit të pedagogut dhe përgjegjësit të departamentit përkatës në javën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.</p> <p>Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë të semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për çdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Të drejtën për të punuar diploma në programin e studimit menaxhim-biznesi e kanë studentët me mesatare mbi 7.5, duke iu referuar rregullores së studimeve në AU. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar dhe pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Referenca: Rregullore e programit të studimit Bsc. MB; Vizita në Institucion.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se çdo fillim viti akademik, Departament i Shkencave Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera brenda institucionit zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit. Gjithashtu, AU përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike publikon udhëzues të posaçëm.</p> <p><u>Referenca:</u> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se AU vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni shoqërues dhe vizita me studentët se studentët informohen mbi programet e studimit dhe kurrikulat që në momentin e parë të kontaktit me pedagogët përkatës, sekretaritë dhe faqja zyrtare web e AU për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. <i>Referenca: www.albaniauniversity.edu.al ; Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë vënë e materiale informuese nënformet një dosje të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit, lista e literaturës së detyrueshme dhe plotësuese. Të cilat u jepën studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore. <i>Referenca: www.albaniauniversity.edu.al ; Vizita në Institucion; Rregullore e programit të studimit Bsc. MB; Rregullore e përgjithëshme.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstatoi se Institucioni përmes zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (ZKA) informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese. Mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat institucioni bashkëpunon etj. Studentët janë përfshirë në aktivitete informuese për ti njohur me kërkesat e punëdhënësve. Studentët përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit.



	<i>Referenca: Leksion i hapur "si të punësohesh"; Leksion i hapur për nxitjen e për nxitjen e studentëve për punësim; Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambientet e Universitetit, në sekretarinë online, në klasat Microsoft Teams dhe në faqen e tij web, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor. <i>Referenca: Agjenda e javës orientuese; Vizita në Institucion.</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se nëpërmjet faqes web zyrtare të AU dhe hapësirës së dedikuar në platformën Teams dhe asaj Pitagora, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të AU. Gjithashtu studentët, sipas programit të studimit, mund të konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara në nivel departamenti. <i>Referenca: faqja web; Platforma Teams; Platforma PITAGORA; Vizita në Institucion.</i>			
Konkluzione	<i>Në AU studentët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritë dhe faqja zyrtare web e AU për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Fakulteti kujdeset për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi. Informimi në distancë realizohet edhe përmes faqes web zyrtare të AU dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																			
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se AU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.</p> <p><i>Referenca: Rregullore E FE-Së ; Të Dhëna Për Studentët Për Akreditimin; Rregullore E Programit Bachelor Financë-Kontabilitet; Vizita në Institucion.</i></p>																																			
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në AU, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 5 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të transferuar në vite të ndërmjetme</th> <th>Të diplomuarve</th> <th>Nr aktual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>65</td> <td>10</td> <td>67</td> <td>75</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>39</td> <td>15</td> <td>41</td> <td>54</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>23</td> <td>13</td> <td>62</td> <td>36</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>30</td> <td>12</td> <td>46</td> <td>42</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>35</td> <td>8</td> <td>24</td> <td>43</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td colspan="4">273</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të transferuar në vite të ndërmjetme	Të diplomuarve	Nr aktual	2018-2019	65	10	67	75	2019-2020	39	15	41	54	2020-2021	23	13	62	36	2021-2022	30	12	46	42	2022-2023	35	8	24	43	Totali	273			
Viti akademik	Të regjistruar	Të transferuar në vite të ndërmjetme	Të diplomuarve	Nr aktual																																
2018-2019	65	10	67	75																																
2019-2020	39	15	41	54																																
2020-2021	23	13	62	36																																
2021-2022	30	12	46	42																																
2022-2023	35	8	24	43																																
Totali	273																																			

	<p>Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Biznesi dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB-BSc. Menaxhim Biznesi (Tabela Pëmbledhëse, Fq29.30); Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se AU se ruan dhe menaxhon të dhënat e statistikore të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të AU kryesisht nga sistemi i brendshëm (Platforma Pitagora). Gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve, tërheqet nga programi, si dhe transferueshmeritë në programe të ndryshme. Të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p><i>Referenca: Tabelat Aneks RVB-BSc. Menaxhim Biznesi (Tabela Pëmbledhëse, Fq29.30); Vizita në Institucion. Platforma Pitagora.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, dokumentacionin shoqërues si dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se AU në aktet e brendshme përcakton mundësinë për ushtrimin e kontroleve periodike pranë njësive përgjegjëse për menaxhimin. Zyra e Sekretarisë Mësimore kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve & dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Kryesekretari i Fakultetit përgatit dhe dorëzon pranë Dekanatit dhe Rektoratit, një raport të veçantë me të dhëna të detajuara mbi realizimin e detyrave e të fushave që mbulon.</p>



	<i>Referenca: Rregullore e Përgjithëshme; Statuti i AU; Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Platforma Pitagora; Vizita në Institucion.</i>		
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ konstatoi se AU Sekretaritë mësimore hartojnë raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e këshillimit të karrierës ALUMNI si edhe DSHE disponon raportet në lidhje me punësimin e studentëve. Njësia bazë mbështetet në këtë informacion për të realizuar analizat periodike. <i>Referenca: Rregullore e programit të studimit Bsc. MB; Vizita në Institucion.</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se AU mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i AU mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. DSHE në bashkëpunim me Zyra e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se AU në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të AU, dhe



<p>ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>në Komisionin për kurrikulën, Komisionin për Vlerësimin Institucional, Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.</p> <p><i>Referenca: Takimi Me Studentët; Statuti AU; Rregullore e programit të studimit; Rregullore e përgjithëshme</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin e AU (neni 47 të drejtat e studentëve) dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent.</p> <p><i>Referenca: Statuti AU; Takimi me Studentët.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se aktualisht AU përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor dhe stafin akademik. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Gjithashtu në bazë të nenit 25 të Statutit të AU studenti me anë të përfaqësimeve të tij në Senatin Akademik të AU, në Komisionin për kurrikulën, Komisionin për Vlerësimin Institucional, Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë me anë të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, ata bëhen pjesë e vendimmarrjes në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Referenca: Statuti AU; Takimi Me Studentët.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e AU, GVJ konstatoi se në çdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. Në rregulloren e programit të studimit BSc. MB është e përcaktuar procedura që studenti ndjek në rastet kur ai konstaton dhe gjykon se duhet të rishikojë vlerësimin e provimit. Ndërmjet një kërkese me shkrim i cili i dikton</p>

njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Dekanit të Fakultetit ngritjen e një komisioni ad hoc për të rivlerësuar provimin brenda një jave.</p> <p><i>Referenca: Rregullore e programit të studimit Bsc. MB, Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se AU ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të AU, dhe në Komisionin për kurrikulën, Komisionin për Vlerësimin Institucional, Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin, si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni përdor edhe pyetësozin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin.</i></p> <p><i>Kuadri rregullator i AU, parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim, por GVJ konstatoi se studentët paraqesin nevojë për më shumë komunikim me personelin akademik.</i></p>			
tShkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<p>Standardi V.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se rregullorja e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët si dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni janë dy njësitë kryesore në shërbim të informimit të studentëve. Konkretisht, këto struktura në bashkëpunim me njësitë bazë të AU dhe ndihmuar nga platforma Pitagora në përdorim ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor. Sekretaritet dhe Zyra e Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel</p>

	<p>Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><i>Referenca: Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve; Rregullore e zyrës së karrierës dhe Alumni; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se rregullorja e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët si dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni parashikohen procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve. Orientimi dhe këshillimi i studentit nis me informimin e maturantëve dhe programet e studimit të ofruar. Departamenti i Shkencave Ekonomike ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimeve të zhvilluara me pedagogët.</p> <p><i>Referenca: Manuali i Studentit; Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve; Rregullore e zyrës së karrierës dhe Alumni; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ALUMNI i cili funksionon në nivel Universiteti u ofron studentëve informacion të posaçëm në lidhje me mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese, mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat Institucioni bashkëpunon.</p> <p><i>GVJ rekomandon shikimin e mundësisë së realizimit e organizimit nëpërmjet ALUMN-it të një Panairi Pune me qëllim rritjen e kontakteve të studentëve në prag diplomimi me tregun e punës.</i></p> <p><i>Referenca: Udhëzues për Zhvillimin e Karrierës; Aktivitete Ekstrakurrikulare; Institucione dhe Organizata Bashkëpunuese ; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të</p>	<p>GVJ konstatoi se ZKA gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar duke u kujdesur në mënyrë periodike për krijimin e nje databaze statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Duke disponuar një bazë të dhënash të përditësuar mbi punësimin e të diplomuarve ndër vite apo të dhëna mbi studentët që vazhdojnë studime të mëtejshme.</p>

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<i>Referenca:</i> <i>Statistika të Punësimit</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>Sekretaritetë Mësimore, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit të AU janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Zyra e Këshillimit të Karrierës duke bërë edhe gjurmimin e punësimit të studentëve të diplomuar. Megjithëse ky standard do ishte më i plotë nëse Institucioni nëpërmjet ALUMNIT do të përfshinte organizimin e një Panairi Pune në mënyrë të përvitshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar në dosjen e vetëvlerësimit, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e AU, GVJ konstatoi se AU ka struktura dhe procedura të mirëpërcaktuara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë SBC në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. AU ka ngritur NJSBC-në në përputhje me rregulloren e NJSBC-së së AU i cili në zbatim të ligjit realizon 2 pyetësorë vjetor institucional për matjen e performancës.

	<i>Referenca: Shembull Pyetësori i Plotësuar në Microsoft Teams; Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni përmes NJSBC, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin në bashkëpunim me njësitë bazë, vlerëson dhe miraton raportet mbi monitorimin e aftësive të mësimdhënies dhe inovative të personelit akademik, ndihmës akademik. <i>Referenca: Rregullore e Përgjithshme; Shembull Pyetësori i Plotësuar në Microsoft Teams; Shembull i Raportit Semestral; Vizita në Institucion.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ konstatoi se Institucioni ka në funksionim e tij Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave u konstatua se kuadri rregullator i AU u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC. <i>Referenca: Rregullore NJSBC; Statuti AU; Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022-2025;</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi nga RVB se të dhënat pasi përpunohen nga NJSBC, i vihen në dispozicion Departamentit i cili i diskuton në tërësi në mbledhjen e radhës. Rastet specifike, apo shqetësuese, diskutohen personalisht me personat e interesuar. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes emailit dhe në Departament.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në informacionin e RVB dhe Dokumentacioni i vënë në dispozicion, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues së NJSBC, GVJ konstatoi se në fund të çdo semestri, përpara sezoneve të provimeve, studentëve ju vihen në dispozicion pyetësorët, rezultatet e të cilëve më pas analizohen sipas kuadrit rregullator të NJSBC <i>Referenca: Shembull Pyetësori i Plotësuar në Microsoft Teams; Vizita në Institucion.</i>
Konkluzione	<i>Kuadri rregullator i AU u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankime dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat</i>

	vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se AU për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika në nivel institucional si dhe ka ngritur struktura përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur. <i>Referenca: Rregullore NJSBC; Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në AU me vendim të Senatit Akademik ka ngritur një sërë organesh në shërbim të sigurimit të Sistemit të brendshëm të Cilësisë. Bazuar në nevojat e Institucionit si edhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase, NJSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm të angazhuar pranë tij edhe në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të kurrikulave. <i>Referenca: VS-Krijimi i ZBC-23.07.2010; VS-Krijimi i KVI-22.12.2016; VS-SC në Nivel Departamenti-8.9.2016; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2019-2020; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2020-2021; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2021-2022; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2022-2023; Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022-2025; VB-E. Pano Konsulente Juridike pranë NJSBC; VB-B. Kola Konsulent për</i>



	<i>Zhvillimin e Kurrikulave; Rregullore për Mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në AU.</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ vlerëson duke u bazuar në RVB se AU për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit ka përdorur një sërë metodash të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Njëkohësisht programi BSc. MB, në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë në 27.10.2018 me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 79 është akredituar duke përcaktuar një sërë rekomandimesh. Të cilat përmeshja e tyre janë vlerësuar në fillim të këtij RVJ. <i>Referenca: Vizita në Institucion;</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e AU paraqiten qartë politikat e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit paraqiten në strategjinë e zhvillimit institucional, pika 7 si dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së Institucionit. Në përfundim të vitit akademik grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit në të cilin paraqiten të dhëna për programin e studimit. <i>Referenca: Rregullore NJSBC – FE; Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në AU procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Instrumentat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i>			
Shkalla e përmeshjes së standardit	Nuk përmeshet	Përmeshet pjesërisht	Përmeshet kryesisht	Përmeshet plotësisht
				X



Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, RVB. GVJ konstatoi se në AU, përveç strukturave specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë ka ngritur dhe Grupet e sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti, si grupe ad hoc, të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësive bazë. Më pas njësia bazë me grupet e sigurimit të cilësisë harton raportin vjetor duke vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha programet që ofron. Ky raport i përcillet NJSBC-së si edhe njësive Kryesore Përkatëse e cila këtë informacion e përfshin në raportin vjetor të saj. Në raportin vjetor përfshihen edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm.</p> <p><i>Referenca: Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2019-2020; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2020-2021; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2021-2022; Pedagogët Përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë 2022-2023; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi nga RVB se DSHE në nivel departamenti përdor instrumenta si pyetësorët me qëllim marrjen e feedback-ut nga studenti. Në funksion të nxjerrjes së problematikave të ndryshme. Të cilat prekin drejtpërsëdrejti programin BSc. MB.</p>



<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB se në nivel institucional është hartuar nga NJSBC dhe është miratuar nga AU paketa e instrumenteve matës të cilësisë me metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Siç është metoda e drejtpërdrejtë e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies është pyetësori i studentëve në fund të çdo semestri. Analiza e raporteve të pyetësorëve të cilat diskutohen në mbledhjet e departamentit.</p> <p><u>Referenca:</u></p> <p><i>Shembull Pyetësori i Plotësuar në Microsoft Teams, Shembull Raport Semestral; Shkresë Fokus-Grupe 2018-2019; Shkresë Fokus-Grupe 2019-2020; Shkresë Fokus-Grupe 2020-2021; Shkresë Fokus-Grupe 2021-2022; Shkresë Fokus-Grupe 2022-2023; Pyetësorët e Personelit Akademik-bdihmës akademik 2019-2020; Pyetësorët e Personelit Akademik-bdihmës akademik 2019-2020; Pyetësorët e personelit administrativ; Pyetësorët e Studentëve 2019-2020; Pyetësorët e studentëve 2020-2021; Pyetësorët e studentëve 2021-2022; Rezultatet e pyetësorëve drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit, RVB. GVJ konstatoi se në AU pjesë e metodave të vlerësimit janë edhe vlerësimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve, si edhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik, apo studentëve kur vlerësohet si e domosdoshme. Gjatë vitit akademik 2021-2022 është zhvilluar gjithashtu një pyetësor mbi “Lumturinë në punë” drejtuar stafit akademik dhe administrativ të AU. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë.</p>

dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.									
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se kuadri rregullator i AU parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni NJSBC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. AU së fundmi ka pasuruar kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</i>								
soriShkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB se AU në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë bashkëpunon ngushtë edhe me ekspertë të jashtëm, kryesisht nga institucione me të cilat Njësia Bazë ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi. <i>GVJ e vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave nga jashtë të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së	Në rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NJSBC përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në AU, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës



<p>programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të AU.</p> <p><i>Referenca: Rregullore NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se AU garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke pasur një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në të. Gjithashtu institucioni nëpërmjet kuadrit rregullator dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë ka mundësuar marrjen pjesë të aktorëve të brendshëm e të jashtëm të cilët kanë ndikim në realizimin e programit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Rregullore NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB se AU respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare si dhe respekton Rregulloren e Përgjithshme dhe Kodin e Etikës të AU.</p> <p><i>Referenca: Kodi i Etikës, Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se AU angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në fazën e rishikimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20 %. Institucioni në mënyrë të vazhdueshme angazhon dhe merr konsulta me ekspertë të jashtëm për përmirësimin e programit të studimit BSc. MB.</p> <p><i>Referenca: RVB; Vizita në Institucion.</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i AU përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, AU realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB se AU në përfundim të çdo viti akademik dërgon pranë MASR raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe Kërkimore-Shkencore të Institucionit si edhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen web. Gjithashtu Informacionet për programet e studimeve, të drejtat dhe detyrimet e studentëve e të tjera informacione të rëndësishme u vendosën në dispozicion studentëve si në format të shkruar ashtu edhe në format elektronik, këto informacione mund të gjenden në faqen web të AU.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>https://albaniauniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshëm-i-cilësisë/</p> <p>https://albaniauniversity.edu.al/sq/broshura-për-ciklin-e-parë-dhe-te-dyte-te-studimeve/</p> <p>https://albaniauniversity.edu.al/sq/manuali-i-studentëve/</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB si edhe nga informacioni në faqen web se AU, në publikimet zyrtare në faqen web të AU dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike.</p> <p><i>Referenca: R. Vjetor AU 2021-2022; Vlerësimi i Informacionit në ëeb; Vizita në Institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit si dhe raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik ku adresohen masat që duhen analizuar dhe prioritetet akademike-shkencore që duhen përmbushur. Departamenti i reflekton këto adresime në fillim të vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitetet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme. Institucioni në fillim të çdo viti akademik nëpërmjet javës orientuese, trajnimeve të shumta si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm informon studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.</p> <p><i>Referenca: www.albaniauniversity.edu.al ; Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i AU përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni</i></p>

	<i>siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik në nivel departamenti dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. AU realizon përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Biznesi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet në një fushë e cila perceptohet si një nevojë përherë e madhe për t'u plotësuar dhe me specialistë përkatës në tregun e punës.
2. Programi Bachelor në “Menaxhim Biznesi” përbën risi në ofertën akademike të fakultetit, të transformuar për t'iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.
3. Institucioni ka një larmi të konsiderueshme të marrëveshjeve bashkëpunimi me partnerë vendas dhe sidomos të huaj. Duke siguruar nga keto marrëveshje edhe ekspert të jashtëm të vlerësimit të cilësisë.
4. Institucioni ka një numër të marrëveshjeve gjithnjë e në rritje me institucionet e tjera dhe biznesin.
5. Sistem efektiv i sigurimit të cilësisë, me struktura dhe përgjegjësi të qarta, që shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.
6. Institucioni avantazhohet sidomos nga një vendndodhje e favorshme.

Pika të dobëta:

1. Struktura e programit të studimit nuk është plotësisht në përputhje me përshkrimin e veprimtarive formuese të përcaktuara me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. (**Fusha II_Standardi II.4_Kriteri 3**).
2. Programi i studimit nuk ka një profilizim të qartë në fushën menaxhimit të biznesit. (**Fusha II_Standardi II.1_Kriteri 2; Standardi II.4_Kriteri 3, 6 & 7**).
3. Staf akademik PAE në Departamentin e Shkencave Ekonomike DSHE rezultojnë me një sasi orësh fizike në auditor shumë të lartë, deri në 560 dhe 660 orë për një pedagog. Duke ndikuar në cilësinë, jo vetëm akademike mësimore, por duke u bërë pengesë edhe në drejtim të kërkimit shkencor. Staf akademik PAE në programin e studimit rezultojnë me një sasi lëndësh të realizuara shumë të lartë, deri në 8 dhe 9 lëndë në vit 2022-2023. Duke rënë ndesh me kornizën ligjore në fuqi, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268. (**Fusha IV_Standardi IV.1_Kriteri 2**).
4. Ngarkesa mësimore në programin e studimit të ciklit të parë mbulohet nga stafi akademik efektiv PAE nën masën 70% në vitet e fundit akademike. (**Fusha IV_Standardi IV.1_Kriteri 2**).
5. Në mjediset e bibliotekës e AU konstatohet kapacitet i kufizuar me mjete kompjuterike (desktop_ë, pc, etj) në dispozicion të studentëve dhe jo vetëm. (**Fusha IV_Standardi IV.2_Kriteri 2**).
6. Rekrutimi si staf në kategorinë PAE në këtë program studimi BSc. MB, punonjës ekzistues efektiv në AU, madje me funksione drejtimi shumë të rëndësishme (ku mund të konsiderohet edhe si konflikt interesi). (**Fusha IV_Standardi IV.1_Kriteri 4**).

Rekomandime:

1. Njësia bazë e programit të studimit duhet të konsiderojë shpërndarjen e lëndëve ku në kategorinë bazë të ketë vetëm lëndë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të formimit profesional apo financiar si Bazat e Financës, Hyrje në mendimin ekonomik dhe Matematikë financiare. Në kategorinë karakterizuese duhet të ketë më tepër lëndë të fushës së menaxhim biznesit..
2. Njësia bazë e programit të studimit duhet të kujdeset për të garantuar profilizimin apo specializimin e studentit në një fushë të caktuar të menaxhimit të biznesit dhe të mos zhvendoset në drejtim të fushave të tjera si financa apo shkencë juridike.
3. Njësia bazë duhet të kujdeset në hartimin e strategjisë të zhvillimit të programit të studimit.
4. Staf i akademik PAE i Departamentit të Shkencave Ekonomike i cili administron programin BSc. MB, duhet të reduktojë sasinë e orëve fizike në auditor në funksion të cilësisë jo vetëm akademike mësimore por edhe asaj të kërkimit shkencor.
5. Staf i akademik PAE i Departamentit të Shkencave Ekonomike i cili administron programin BSc. MB, duhet të reduktojë sasinë e lëndëve të realizuara në nivel viti akademik, brenda kornizës ligjore në fuqi, referuar Udhëzimit Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268.
6. Ngarkesa mësimore në programin e studimit të ciklit të parë duhet të mbulohet nga stafi akademik efektiv PAE mbi masën 70% sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.
7. IAL duhet të krijojë dokumentacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të zhvillimit të praktikës mësimore.
8. Njësia përgjegjëse për programin e studimit – Departamenti i Shkencave Ekonomike duhet hartojë raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Biznesi
9. Literatura e sugjeruar në programin mësimorë duhet përditësuar mbi bazën e botimeve të 5 viteve të fundit.
10. Njësia bazë e këtij programi studimi duhet të dokumentojë listën e mobilitetit si për pedagogët edhe për studentët incoming dhe outgoing.
11. Domsdoshmërinë e rritjes së kapacitetit dhe mjeteve kompjuterike nënjet desktop_ëve, pc, etj. Në dispozicion të përdoruesve të bibliotekës e-book në mjedisin e bibliotekës. Në mënyrë që biblioteka on line të mund të aksesohet nga sa më shumë studentë njëkohësisht në funksion të përgatitjes së tyre për detyrimet e lëndëve por edhe për punët kërkimore.
12. AU si edhe DSHE duhet të ketë në konsideratë evitimin e praktikave të rekrutimit si staf në kategorinë PAE, në këtë program studimi, punonjës ekzistues në AU madje me funksione drejtimi të larta e shumë të rëndësishme (me qëllim shmangien e konfliktit të interesit).
13. Përditësimi dhe plotësimi i CV të stafit akademik efektiv PAE (mundësisht brenda të njëjtit format).

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor " Business Management" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"

Strengths and affirmations

1. The study program is offered in a field which is perceived as a permanent need to be filled and with relevant specialists in the labor market.
2. The "Business Management" bachelor's degree represents a novel addition to the faculty's academic offerings, designed to address the country's developmental needs.
3. The institution has a significant variety of cooperation agreements with domestic and especially foreign partners. Providing external quality assessment experts from these agreements.
4. The institution has a growing number of agreements with other institutions and business.
5. Effective quality assurance system, with clear structures and responsibilities, that serve continuous quality improvement.
6. The institution is especially advantaged by a favorable location.

Weaknesses

1. The structure of the study program is not fully in accordance with the description of formative activities defined by VKM No. 41, dated January 24, 2018.
2. The study program does not have a clear profile in business management.
3. Effective Academic Staff EAS / PAK in the Department of Economic Sciences DES/DSHE result in a very high amount of physical hours in the auditorium, up to 560 and 660 hours for a lecturer. Influencing the quality of not only academic teaching but also becoming an obstacle in terms of scientific research. Effective Academic Staff EAS / PAK in the Department of Economic Sciences DES/DSHE result in a very high amount of completed subjects, up to 8 and 9 subjects per year. Contrary to the legal framework in force, referring to Instruction No. 29, Date 10. 09. 2018. No. 9268.
4. The teaching load in the first cycle study program is covered by the Effective Academic Staff EAS / PAK below 70% in the last academic years.
5. In the premises of the AU library, there is a limited capacity with computer tools (desktops, PCs, etc.) available to students.
6. Recruiting as staff in the PAE category in this study program, effective existing employees in the AU even with very important management functions (where they may be considered with a conflict of interest).

Recommendation

1. The basic unit of the study program should consider the distribution of subjects, where in the basic category there are only subjects of a general nature and not of professional



or financial training, such as Basics of Finance, Introduction to Economic Thought, and Financial Mathematics. In the characteristic category, there should be more business management courses.

2. The study program's basic unit must ensure the student's profiling or specialization in a specific field of business management, preventing them from straying into other fields like finance or legal science.
3. The basic unit should take care when designing the study program's development strategy.
4. Effective Academic Staff EAS / PAK of the Department of Economic Sciences DES/DSHE who administers the BSc study program. MB, should reduce the amount of physical hours in the auditorium in function of the quality of not only academic teaching but also that of scientific research.
5. Effective Academic Staff EAS / PAK of the Department of Economic Sciences DES/DSHE who administers the BSc study program. MB, must reduce the amount of subjects completed at the level of the academic year, within the legal framework in force, referring to Instruction No. 29, Date 10. 09. 2018. No. 9268.
6. The teaching load in the first cycle study program must be covered by the Effective Academic Staff EAS / PAK over 70% according to Council of Ministers Decision CMD/VKM No. 418, dated 10.05.2017.
7. The HEI must create the necessary documentation for the teaching practice development process to run smoothly.
8. The Department of Economic Sciences, the unit responsible for the study program, must draw up analytical reports of the benefits of cooperation agreements in order to complete the bachelor's study program in "Business Management."
9. The literature suggested in the curriculum should be updated based on the publications of the last 5 years.
10. This study program's basic unit must document the mobility list for both lecturers and incoming and outgoing students.
11. The necessity of increasing the capacity and computer tools among desktops, PCs, etc. available to the users of the e-book library in the library environment. So that the online library can be accessed by as many students as possible at the same time in order to prepare them for the obligations of the subjects but also for the research work.
12. AU as well as DSHE should consider avoiding recruitment practices as staff in the PAE category in this study program, existing employees in AU even with very important management functions (in order to avoid conflict of interest).
13. Updating and completing the CV of the effective PAE academic staff (preferably in the same format).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



